

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.3(429)

MARS 2024

ÇMIMI: 30 LEKË

Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

## TAKIMI

**IZET VEÇANI**  
HISTORIA  
E GJALLË E  
FLOTËS TONË  
LUFTARAKE



**SHPENDI TOPOLLAJ**

FAQE 4

## HISTORIA

**RIZA GJOKA,**  
KRENARI E  
DARDHËS  
DHE DIBRËS




**Nga Muharrem GJOKA**

FAQE 8

## PROFIL

**REFORMATORI**  
I USHTRISË  
SHQIPTARE...

Veprimtar i nacionalizmit shqiptar. Usharaku nga Di-bra e Madhe që u pushkatua nga gjyqi "special" i Tiranës i 13 prillit të vitit 1945



**Nga Sakip CAMI**

FAQE 5

*Kryesia e OBVL ka hartuar dhe miratuar një program të ngjeshur veprimtarish*

# 30-VJETORI I KRIJIMIT, OBVL NË START TË MBARË

## MBROJTËSE E

**VLERAVE TË LIRISË**

**Halil RAMA**

FAQEN 3

**NDERIMI PËR MËSUESIN  
VETERAN MENTOR DOMAZETI**



FAQEN 9

**SIGURIA KOMBËTARE,  
MINISTRI PELESHI  
KONSULTIM ME  
USHTARAKË TË  
LARTË DHE EKSPERTË  
TË FUSHËS**

FAQEN 11

**SHPENDI TOPOLLAJ  
ME DY LIBRA TË RINJ!**

**Nga Fatmir Minguli**

FAQEN 15

**PËRMENDORE ME  
FJALË SHPIRTI**

**Nga Liljana MUÇA**

FAQEN 15



*E krijuar para 30 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) do të bëhej promotore e mbrojtjes së vlerave tona kombëtare*

FAQEN 3

**GJENERAL NEXHIP VINÇANI DHE BRIGADA QË S'U BË  
"HERO I POPULLIT" NGA KOZMA GJINI**

FAQEN 2

## HOMAZH



**U shua  
kolonjari  
dhe atdhetari  
Myslim Islami**

**Agron Seamini**

FAQEN 16

**KRISMAT E MALIHERIT**

**Neki ÇAKO**

FAQEN 14

## DOSSIER

**"TEZAT E ZEZA TE  
BALLUKUT", SI U PËR-  
JASHTUA NGA USHTRIA  
DEKANI MUJO SOKOLAJ**

FAQEN 6

## 80 VJETORI

**BRIGADA E VII-TË  
SULMUESE, 120 BETEJA  
DHE 3200 KILOMETRA  
MARSHIME**

FAQEN 10

## OPINION

**KOSOVA 16 VITE  
PAS SHPALLJES SË  
PAVARËSISË**

**Nga Bashkim Hisari**

FAQEN 12

## PROFILE

**'500 VJET KRALJAT KANË  
THANË, RUAJU FORT KU  
TË KETË SHALJANË!**

**Nga Gjin Musa**

FAQEN 13

## 95 - VJETORI I LINDJES

**JA PSE VETERANI I LANÇ  
GENC BALLANCA NDEROHET  
E RESPEKTOHET NGA TË  
GJITHË**

**Bashkim Kadiu**

FAQEN 14

## SPECIALE

Me rastin e 80-vjetorit të krijimit të Brig. IV-S

# GJENERAL NEXHIP VINÇANI DHE BRIGADA QË S'U BË "HERO I POPULLIT"

## NGA KOZMA GJINI

Nexhip Vinçani ishte një ushtarak e komandant autoritar, orator, ideator dhe praktikien i përkryer luftarak, por ishte edhe një njeri i shkëlqyer e me zemër të madhe, i afërshëm, i dashur, i arsyeshëm me vartësit. Nuk mund të harrohet përplasja trup më trup për hakmarrje midis dy ushtarëve, ku ngjarja pritej të kalonte në gjyqin ushtarak e njëri nga ata do të pushkatohej, (sipas ligjit të luftës), por ishte ndërhyrja e zgjuar në kohë e komandant Nexhipit që e zgjidhi situatën dhe i shpëtoi jetën tjetrit.

Kurbani i rradhës...!

...Kujtdo që e ka njohur sadopak jetën e N.Vinçanit, natyrshëm i lind pyetja: "Pse E. Hoxha nuk e donte në erë Nexhipin? Pse kaq agresiv ndaj tij? Përse e mohoi dhe e hodhi poshtë kontributin e madh të tij në luftë? Pse e shkeli me këmbë bukën që kishte ngrënë në shtëpinë e Nexhipit? Pse kaq mllef deri në eliminimin nga çdo detyrë dhe përndjekjen baltrave të vendit e shkatërrimin e tij fizik, moral e familjar?"


"...Filozofia drejtuese e E. Hoxha ishte "copy paste" e filozofisë staliniane: "divida et impera" = përça e sundo"! Kjo ishte vija e "artë" e sundimit të diktatorëve dhe këtë e ka pohuar edhe shkrimtari ynë D. Agolli etj." "Kush më shkel në kallo, ia "pres gjuhën". Nexhipi ishte njëri nga kuadrot më të përgatitur ushtarak që kishte mbaruar Akademinë e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Sovjetike "Voroshilov" dhe i pakompromentuar me kompleksitetin e agjenturës jugosllave që përvijoi "Plenumin e Zi" të PK.

Në Konferencën e Tiranës, Enveri donte që ta implikonte dhe Nexhipin me grupin e delegatëve që ngritën probleme kundër udhëheqjes së lartë të PPSH. (Ndonëse Nexhipi nuk ishte fare delegat). Në këtë kohë ai ishte me shërbim në Durrës, Komandant i Mbrojtjes Bregdetare). Gjatë seancës së Konferencës, Enveri iu drejtua kolonel Iljaz Ahmetit: "Pa hë Iljaz, na thuaj: Çfarë ju thoshte Nexhip Vinçani për shokët e udhëheqjes?" Iljaz Ahmeti jo vetëm që nuk foli kundër Nexhipit, përkundrazi e mbrojti. Këtë gjë, E. H. ia mbajti "vëth" në vesh. Do të thirrej në Byronë Politike: "Kërkoni t'i zini vendin Beqir Ballukut?" Nexhipi cilësohet "antiparti" dhe u përjashtua nga Plenumi i KQ, u shkarkua nga detyra e Zv/Shefit të Shtabit të Përgjithshëm e u dërgua në Elbasan, si Shef i Degës Ushtrake e më pas: komandant Divizioni në Tiranë e Komandant të Mbrojtjes Bregdetare në Durrës. Në këto detyra ai qëndroi deri në janar 1958, kur do ta shkatërronin moralisht, e liruan nga ushtria dhe më pas e arrestuan. Po cili ishte shkaku i vërtetë i goditjes së Nexhipit dhe si erdhi arrestimi i tij? Pa asnjë bazë, Nexhipi u akuzua se "në bashkëpunim me Gjin Markun e Tahir Kadarenë, gjoja kishin tentuar të organizonin një komplot për të rrëzuar nga drejtimi i Ministrisë së Mbrojtjes, gjeneral-leitnant, Beqir Ballukun dhe ta merrin vetë drejtimin e asaj ministrie." Koha tregoi se akuza e "komplotit" ishte false...

Enveri e shkarkoi dhe e goditi Nexhipin, se në Kongresin e Parë të Partisë, ai nuk u çua që të kritikonte Gjin Markun, kur ky i fundit, i kërkoi Koçi Xoxes që të "thellohej" në autokritikën e tij. PS: "Thellimi" nënkuptonte se në këtë përgjegjësi, kishte pjesën e tij edhe E.Hoxha. Po, a mund ta pranonte ai këtë gjë?! Nga gjithë ajo përndjekje këmba-këmbës del se Enveri e ka dashur të vdekur Nexhipin, (ashtu si dhjetra të tjerë), por i mungonin faktet.

Në një mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm me kuadrot kryesorë të qarkut të Korçës, në marsin e '44, Koçi Xoxe u shpreh: "Këtu në qarkun e Korçës nuk ndjehet fare Partia dhe udhëheqja..., por vetëm Nexhip Vinçani". Kjo thënie e Koçit ishte si një paralajmërim për Nexhipin, që të ruhej se mbi krye kishte një "usta" që survejonte për t'ia gjetur ditën e keqe...Por, vet Enveri ia kishte dhënë një përgjigje pyetjes së Koçit në një tjetër rast, duke i thënë:

"...Që të ngresh autoritetin tënd dhe të Partisë, ti Koçi, mos rri në prapavija (Bakull, Lavdar, Panarit etj), por shko atje ku shkon Nexhipi me Pëllumbin, atje do të njihesh me komandantët, komisarët e do të të



respektojnë ty dhe Partinë". Pavarësisht "divergjencave" mes tyre, pikpamja e Koçit me të Enverit, ishin në sinkron kur vinte fjala për qendrimin ndaj Nexhipit. Edhe pse Nexhipi e drejtoi me sukses Brigadën e IV-S në luftimet për çlirimin e Tiranës etj, edhe pse u përgjodh si një nga kuadrot më shembullorë të luftës dhe u dërgua për studime në ish-Bashkimin Sovjetik, edhe pse u zgjodh komandant i Mbrojtjes Bregdetare në Durrës, Shef i Drejtorisë Operative në Ministrinë e Mbrojtjes, Zv/shef i Shtabit të Përgjithshëm, kostumi i gjeneralit nuk arriti ta mbronte nga zilia, urrejtja dhe hakmarrja e kupolës shtetërore.

Duhej gjetur një "ganxhë", për të justifikuar arrestimin. Plani i Kadri Hazbiut ishte mirëkurdisur.

"Teksa gruaja e Nexhipit kishte shkuar për të blerë në merkato, shitësja (e infiltuar e sigurimit), i tha asaj që të blente disa ushqime më tepër... Më pas u denoncua për abuzim dhe u arrestua. Qëllimi i sigurimit ishte që ta ndante Nexhipin nga gruaja dhe më pas, asaj i bënin presion që të fliste dhe të akuzonte Nexhipin sipas akuzave që do t'u duheshin...

Sigurimi arriti ta ndante Nexhipin nga gruaja, por Memka nuk pranoi kurrë që të fliste kundër burrit të saj.

"... Enver Hoxha, pas tij edhe të tjerët, asnjëherë nuk e zunë në gojë emrin tim si delegat në Konferencën e Pezës, por për mua ka patur rëndësi fakti që Konferencën e Pezës, do ta ruaj në kujtesën time si aktin e një rëndësie madhore për kombin, pavarësisht se kush ish nismëtari...", ka shkruar gjeneral Vinçani. (Por dihet që atëhere, kryetar shteti, partie, ministrie, kryeministër, kryeparlamentar, kryeprokuror e kryegjyqtar ...ishte vetëm AI.) Nexhip Vinçani ishte vënë në shënjestër shumë herët... për t'u bërë kurban nga Enveri... Jeta e pas "kryqëzimit" për të ishte pasqyra e një sprove për të rezistuar. Nexhip Vinçani karakterizohej nga qendrimi heroik, burrëror, i paparë ndaj torturave fizike, akuzave, shpifjeve, trillimeve, insinuatave, aludimeve, prapaskenave, mashtrimeve, intimidimeve, dhunës psikologjike, gjuetisë së shtrigave dhe provokimeve të sigurimsave... E degdisën deri në skajet ku të mos i dëgjohej zëri, por ai qëndroi dhe erdhi dita të tregonte të vërtetat e luftës, kulisat e udhëheqësve, ndërkohë që ka qënë vet përkthyes në bisedat me ta dhe shtëpinë e ktheu në bazë ku mbledhesh shtabi i vendit dhe vet Enveri me krerët e Jugosllavisë "Tempo" e "Stojniç".

Pas Konferencës së Tiranës, në vitin 1956, gjeneral Nexhip Vinçani, i cili ishte kundër kultit të individit,

shkarkohet nga detyra...kur ende nuk kishte mbushur 40 vjeç, dërgohet si punëtor i thjeshtë në Lushnjë e mandej përgjegjës kantieri në Fier, ku trajtohej si armik. Arrestimi i Nexhipit u bë mbi bazën e Nenit 55 të Kodit Penal, "për agitacion e propogandë". Por kalvari nuk mbaroi me kaq.

Pas dhjetorit 1981, ai ndiqej në çdo hap. Në Tiranë, kur shkante te vëllai, një i njohur i tij e paralajmëroi se po e ndiqte sigurimi për ta arrestuar. Ndërkohë në Lushnjë, ku banonte vajza e tij, e kishin rrethuar shtëpinë me policë. Fjeti këtë natë te vajza. Të nesërmen në mëngjes e përcolli dhëndërrin, dr. Genci Dani deri te stacioni i trenit, ku do të merrte trenin për në Fier. Dhe ashtu ndodhi. Nexhipin e arrestuan në shtëpinë e tij në qytetin e Fierit ku hetuesi i shkoi me një numër të madh policësh, që të bënin bujë e zhurmë të madhe dhe e arrestuan në mënyrë demonstrative në sy të banorëve të lagjes, madje për analogji, duke i kujtuar titullin e librit të Kadaresë, "Hë...! "Gjenerali i ushtrisë së vdekur!?" Në hetuesinë e Fierit do të pyetej edhe për "lidhjet" me oficerët e Misionit Britanik në Shqipëri gjatë luftës. Nexhipi iu përgjigj me ironi: "Po,... kam qënë agjent i italianëve, i jugosllavëve, rusëve, kinezëve, anglezëve, madje dhe i japonezëve..." Atëhere e godasin me mjete të forta, derisa humbi ndjenjat. Po çfarë ndodhi me Nexhip Vinçanin, pasi e liruan nga hetuesia, ku e torturuan për 11 muaj me rradhë? Ndërkohë që kishte kaluar të shtatëdhjetat, i komunikuan internimin për në fshatin Grabovë të Gramshit, pasi më parë i kishin internuar dhe gruan e dytë në fshatin Shtyllas të Fierit. Grabova ishte 8 orë larg Gramshit dhe atë e caktuan të banonte në një kolibe qeni.

Një vështrim, urdhërit për arrestimin e gjeneral Vinçanit. Thënia se urdhërarrestimi ishte firmosur nga Beqir Balluku, bie poshtë, sepse vet Balluku e ka pohuar me gojën e tij: "Jo!" Edhe varianti se urdhërin e ka dhënë Kadri Hazbiu, rrëzohet, sepse ai nuk kishte kompetenca të vendoste për të arrestuar një gjeneral. Atëherë? Për arrestimin e gjeneral Nexhip Vinçanit kishte vendosur kreu i kupolës shtetërore e partiake, vet E. Hoxha.

Me Nexhipin, organet e diktaturës u morën edhe pas internimit të tij. Qëllimi ishte që ta "shtrydhnin", me shpresën se mos nxirrte ndonjë argument për të justifikuar termin "poliagjent" që Enveri damkosi Mehmet Shehun, (vetëvarë më 18/12/1981). Nexhipi ishte një strateg i rrallë ushtarak, sepse edhe në momente të vështira, me intuitë dhe inisiativë, e nxirrte të fituar betejën, madje pa i "marrë dorën" udhëheqjes. Kjo gjë e fuste në ambicie me krerët drejtues.

A ka kontribut më të madh se Nexhipi në Qarkun e Korçës? Nga dëgjesat me bashkëkohës, Nexhipin e rendisin si mendja më e ndritur që ka nxjerrë Korça gjatë luftës. Më 1982 arrestohet për agitacion e propogandë. Dënimi i tij është cilësuar i padrejtë. Veprimtari i shquar i LANÇ-it, gjenerali dhe ushtaraku i lartë, vdiq në Tiranë më 6 shkurt 1997. Gjeneral Vinçani u la vajzave amanetin: "Nuk do t'ju lë një pasuri, por do t'ju lë një emër!"

Nexhip Vinçani është dekoruar me 11 urdhëra e medalje të ndryshme. Ai ka marrë një dekoratë të lartë nga ish-Presidenti shqiptar, z. Alfred Moisiu. Me rastin e 9 Majit 1995, që përkonte me 50 -vjetorin e firores përfundimtare mbi nazifashizmin, është dekoruar edhe nga ish-Presidenti i Federatës Ruse, Boris Jelcin. Korça i ka akorduar titullin "Qytetar Nderi" dhe "Nderi i Qarkut". Më 2021, nga Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, merr dekoratën e lartë "Nderi i Kombit (pas vdekjes).

Shumë bashkëkohës, bashkëluftëtarë dhe pasardhës të veteranëve pohojnë me plot gojë se gjeneral Nexhip Vinçani është "Themistokli Gërmenji i dytë" për Korçën. Ai është një nga mendjet më të ndritura që ka nxjerrë Korça gjatë periudhës së luftës për çlirimin e vendit. Ai është produkt i kohës...

Pse Brigada e IV s'u dekorua me titullin "Hero i Popullit"? Ndërkohë që komandanti i Brigadës së 4 S, na

## JUBILARE

Kryesia e OBVL ka hartuar dhe miratuar një program të ngjeshur veprimtarish

# 30-VJETORI I KRIJIMIT, OBVL NË START TË MBARË

**Halil RAMA\***

Për Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ, 2024 është viti i dy ngjarjeve madhore: 80 vjetori i çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist dhe 30 vjetori i krijimit të saj. Në këtë kuadër kryesia e OBVL ka hartuar dhe miratuar një program të ngjeshur veprimtarish. Gjithsesi kryesia e OBVL sjell në vëmendjen e opinionit publik dhe në mënyrë të veçantë, në vëmendjen qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që ashtu si në përvjetorët tjerë jubilarë është domosdoshmëri krijimi i një komisioni të posaçëm shtetëror gjithëpërfshirës. OBVL kërkon që ky komision të jetë gjithëpërfshirës në dimensionet e vlerave që mbart dhe sjell 80-vjetori i çlirimit të atdheut, me qëllim që programimi i çdo detaji dhe festimi i këtij jubileu të jetë i denjë për këtë ngjarje të madhe, të jetë i denjë për të nderuar sakrificën sublime, gjakun e dëshmorëve, heroizmin e luftës partizane, e cila ishte dhe mbetet lufta më e madhe patriotike që ka zhvilluar populli shqiptar. Kjo sipas kryetarit të OBVL, kolonel Sotir Budina, për faktin se nderimi i 80-vjetorit të çlirimit të atdheut është padyshim një meritë për Shqipërinë evropiane, sepse në themel të Evropës së Bashkuar qëndrojnë vlerat e Luftës së Dytë Botërore

## 30 VJET OBVL, HISTORI SUKSESI

E krijuar para 30 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) do të bëjë promotore e mbrojtjes së vlerave tona kombëtare. Në këtë grup bënin pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane e ministra, siç ishin: Dr. Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçrami, Maqo Çomo, Sadik Bektashi (gjeneral lejtnant-Hero i Popullit), Muhamet Prodani (gjeneral lejtnant-Hero i Popullit), gjeneral-majorët: Nexhip Vinçani, Skënder Malindi, Edip Ohri dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktiviste të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani) e disa të tjera, por fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Me një aktivitet intensiv në mbrojtjen dhe promovimin e këtyre vlerave, dr. Dishnica dhe gjeneral Parllaku arritën ta bëjnë OBVL-në anëtare të Federatave Evropiane dhe Botërore të Veteranëve. Me pjesëmarrjen në aktivitetet e këtyre



Federatave, jo vetëm në Evropë, por edhe në Malajzi, në Johannesburg, Marok etj, OBVL-ja ka bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II Botërore dhe në luftërat për liri të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që jep sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s. Nisur nga ky aktivitet intensive dhe vlerat që mbron e promovon. OBVL

vlerësohet për orientim e drejtë, për veprimtarinë e gjallë të saj, për përskrime të disa jetëve njerëzore, për vetëdijen dhe besimin e veteranëve dhe pasardhësve, anëtarë të organizatës, jo vetëm në luftë, por edhe në demokraci.

## KATËR PERSONALITETE TË OBVL "NDERI I KOMBIT"

Tridhjetë vjet pas krijimit, për

• E krijuar para 30 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) do të bëjë promotore e mbrojtjes së vlerave tona kombëtare

rolin që ka luajtur, si mbrojtëse dhe promovuese e vlerave më të mira kombëtare shqiptare, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftërave për Liri e Pavarësi të Popullit Shqiptar (OBVL) është ndër organizatat më të vlerësuara nga institucionet shtetërore, me katër personalitete "Nderi i Kombit". Me këtë titull të lartë të akorduar nga ish-presidentët Nishani e Meta janë vlerësuar dy kryetarët e parë të OBVL: Dr. Ymer Dishnica e gjeneral Rrahman Parllaku, si dhe gjeneralët Nexhip Vinçani e Veli Dedi.

Ndërkohë, me "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" janë dekoruar ish-themeluesit dhe drejtuesit ndër vite të kësaj organizate: Ish-nënkryetari dhe kryetari i saj, kolonel Myfit Guxholli, ish-sekretari i Përgjithshëm Edip Ohri dhe anëtarët e kryesisë: Liri Belishova e Hamit Keçi; ndërkohë që drejtuesit aktualë të OBVL: Sekretari i Përgjithshëm, akademik Halil Rama, nënkryetari Muharrem Gjoka dhe kryetari i Degës së OBVL Pukë, studiuesi dhe shkrimtari i mirënjohur Xhemal Meçi janë dekoruar me titullin "Mjeshtër i Madh". Po ashtu, me propozimin e OBVL ju është akorduar "Dekorata e Artë e Shqiponjës" komandantit të Çetës së parë Partizane të Gollobordës, patriotit të madh me rrezatim mbarëkombëtar Ahmet Cami, si dhe ish-kuadrit të Brigadës së 18, Ismail Bara.

OBVL, veteranët dhe pasardhësit e tyre, anëtarë të kësaj organizate ndjehen më krenarë se kurrë me vlerësimin që ju bëhet këtyre personaliteteve dhe angazhohen për të ecur në shembullin e tyre, që organizata jonë të vazhdojë të funksionojë si mbrojtëse e flaktë e vlerave të lirisë. Mbrojtja, propagandimi, ruajtja, mbajtja gjallë e vlerave të historisë sonë kombëtare, e veçanërisht atyre të LANÇ-it, dhe transmetimi i tyre te brezat pasardhës është dhe mbetet qëllimi themelor i OBVL-së.

\*Mjeshtër i Madh dhe sekretar i Përgjithshëm i OBVL-së

## TAKIMI

Edhe sot në moshën 96 vjeçare atë e respekton dhe e nderon një qytet i tërë

# IZET VEÇANI HISTORIA E GJALLË E FLOTËS TONË LUFTARAKE



## SHPENDI TOPOLLAJ

Një grup anëtarësh të OBVL Durrës, ditën e lindjes së babait të Kombit Ismail Qemali, vendosëm të shkonim në Vlorë dhe të vinim te monumenti i famshëm një tufë me lule. Kishim dhe një arësye tjetër: do të takonim veteranin e Flotës tonë Luftarake, ish partizanin 96 vjeçar Izet Veçani, i cili kishte qenë shok në shkollën e Marinës në Baku të Gjeorgjisë aso kohe pjesë e Bashkimit Sovjetik, me të ndjerin Adem Jaupi, babanë e shokut tonë Luanit. Do ta pyesnim se si e kujtonte Ademin, kapitenin e njohur të anijes "Mati", edhe pse dyshonim se mos atij i qe dobësuar kujtesa nga moshë e madhe. Por ishim gabuar; Izeti, që pasi kryem ritualin te monumenti dhe bëmë fotot e rastit, dhe që e gjetëm fare kollaj, na mrekullulloi me kujtesën e tij të habitshme. Ishte një burrë i mbajtur mirë, me trup të drejtë, i veshur me sqimë, aqsa besoj se shkopin që kishte në dorë, bashkë me një borsalino që ja shtonte hijeshinë, më shumë e mbante për snobizëm. Ai nuk e fshehu gëzimin kur pa se me ne ishte dhe nipi i tij, ish komandanti i Brigadës Bajram Sulejmani dhe foli me ne sikur të ishim miq të vjetër. Shokët e tij i mbante mend pa përjashtim, emër më emër, madje dinte edhe fatin e tyre pasi u kthyen atdhe. Kujtonte bashkëshortet dhe fëmijët e tyre me hollësi. Pas humbjes së gruas së tij, vdekja e të birit, Eduardit, matematikan e jurist mjaft i aftë, pak vite më parë i cili kishte qenë edhe Prefekti i nderuar i Vlorës, e kishte pikëlluar, por ai kishte ditur të ruante dinjitetin në sytë e vlonjatëve të cilët e donin dhe e respektonin. Ai kishte kryer për një kohë të gjatë detyra të ndryshme si oficer, në repartet e FLD në atë qytet, dhe thujse njihej nga të gjithë. Kishte parë dhe kishte përjetuar aq shumë në jetën ushtarake, sa e gjeta të arsyeshme të shkruaja diçka rreth figurës së tij interesante. Dhe kur këtë ja thashë atij, më sugjeroi që para se ta bëja këtë, për saktësi, të lexonja kujtimet e tij. Dhe ato ishin plot shtatë blloqe të trasha, mbushur me një shkrim fare të qartë, ku qe hedhur në letër deri në imtësi, një jetë e tërë aktive dhe ku para syve të shfaqeshin një mori kuadrosh që ia kushtuan jetën e tyre mbrojtjes së Atdheut. Krijova bindjen në Izeti kishte qenë gjithmonë i kujdeshëm

• *Djalit 14 vjeçar që ishte bashkuar me radhët partizane, atë skënderbegasin e dikurshëm, atë studentin që kishte mbaruar shkollat jashtë dhe brenda vendit me rezultate të shkëlqyera, pra atë kuadrin që kishte fituar zemrat e vartësve dhe kolegëve me aftësitë, përkushtimin dhe ndershmërinë e tij, e shpallnin të padëshiruar dhe e lironin nga ushtria. E çuan lulishtar, atje në rrugën Skelës, ku atë e njihnin të gjithë. Por ai nuk e uli asnjëherë kokën deri sa doli në pension*

për të fiksuar deri në detaje, gjithçka në ato ditare. I lexoja ato kujtime dhe ndërmend më dilnin përpjekjet dhe sakrificat e shokëve të mi oficerë për t'i kryer me nder detyrat dhe për të kapërcyer burrërisht vështirësitë e panumërta të profesionit. Por isha i ndërgjegjshëm se nga kuadrot e marinës, kërkohej një punë më e kualifikuar dhe më shkencore, se e tillë ishte natyra e përvetësimit dhe përdorimit luftarak të mjeteve detare mbi e nënujësë. Ishte ende fëmijë, pra vetëm 14 vjeç, kur u bashkua Izeti me ata që kishin marrë armët për të çliruar atdheun nga pushtuesit. Komandant të parë të batalionit në Br.VII - S të krijuar në Vlush të Skraparit më 17 mars 1944, ka pasur Sabri Sevrani që u plagos rëndë në ndeshje me armikun, nga i cili mori mësimet e para të të luftuarit. Mbresa të pashlyeshme i la atij Nikollaq Sallabanda, zëvendëskomandan-



ti i batalionit të IV - të që pas çlirimit arriti të bëhej komandant Korpusi, por që e pësoi padrejtësisht nga e ashtuquajtura "Fshesë e Hekurt" në ushtri. Izetit i kishin caktuar detyrën e korrierit nga që ishte ende i vogël, dhe ai e shihte sesa me mençuri e guxim e drejtonin atë Brigadë Gjin Marku dhe komisari Kadri Hoxha, sidomos në Berat. Pas betejash të ashpra dhe mijra kilometra marshime deri në zonat e Mirditës, Lezhës, Zadrimeës e Shkodrës, pra kur Shqipëria u çlirua, Izeti u dërgua në shkollën ushtarake "Skënderbej", ku qëndroi deri në vitin 1947. Këtu u pajis me kulturën dhe rregullin që kërkonte ushtria moderne, tani me rregullore të qarta e të detajuara, dhe kujton me dashuri oficerët Vangel Dogga, Ymer Tole, Miço Kola, Filip Stefani, Bajram Tresova, e deri komandantin Halim Xhelo që përfundoi burgjeve pasi shfaqti mos pajtimin me marrinë e heqjes së gradave, si dhe mësuesit e mrekullueshëm që punonin atje. Pas kësaj shkolle nis studimet për oficer në Split të Jugosllavisë, nga ku

pas prishjes së marrëdhënieve, dërgohet me shokët në shkollën e lartë ushtarake - detare në Baku të Bashkimit Sovjetik. Këtu, në kushte jashtëzakonisht të mira pedagogjike e didaktike, ku kishte kabine të pajisura më së miri, një flotë nga më të sofistikuarat e kohës dhe kuadro mjaft të përgatitur, studentët shqiptarë qëndruan për katër vjet dhe në vitin 1952 u kthyen në vendlindje. Izet i kreu studimet me rezultate të shkëlqyera dhe me dijet e tij të kompletuara caktohet të shërbejë në Flotën tonë Luftarake e cila ishte ende në krijim e sipër dhe ku gjen kuadro mjaft të afta si Abdi Mati me shokë. Fillimisht i besohet detyra e komandantit të Grupit Autonom, ku punon me ndërgjegje të lartë, kërkesë llogarie dhe arritje të dukshme nga ana e efektivit. Ai qysh aso kohe e dinte, siç thotë vetë se "Çdo shtet ka ushtrinë e vet, ajo ka një mision shumë të lartë dhe fisnik siç është mbrojtja e Atdheut, prandaj kjo detyrë është shumë e madhe... Ushtaraku është person i rëndësishëm që përfaqson shtetin kudo qoftë". Dhe Flota jonë, me kalim-

in e kohës, erdhi duke u fuqizuar dhe kuadrot tani ishin plotësisht të aftësuar. Ata u rritën bashkë me të. Edhe rrugëtimi i vetë Izet Veçanit është historia e kësaj rritjeje dhe këtij fuqizimi. E nisi si minjer i marinës, e me radhë deri komandant Drage, shef stërvitje i shkollës së Instruksionit, komandant i kësaj shkolle, komandant i Grupit të Dragaminave, Katerave etj. Kudo u dallua për seriozitet, kulturë, ndershmëri dhe manifestoi gjithmonë një shpirt krijues. Shpesh i duhej të merrej me gjithçka; deri me rregullimin e mjedisve për fjetje, ngrënie, argëtim e stërvitje të efektivit. Dhe gjithmonë ia doli me sukses, pasi ai interesohet deri edhe për vogëlsitë. Mbi të gjitha ai ishte njeri me karakter të fortë që nuk pajtohej me të metat dhe mendimet e tij i thoshte hapur edhe kur kështu nuk mendonin eprorët e tij. Gjithë jetën e kujtonte me krenari qëndrimin e gjithë efektivit gjatë prishjes së marrëdhënieve me sovjetikët. Pa aty trimërinë dhe patriotizmin e Shtabit të Përgjithshëm, admiralëve tanë, oficerëve madhorë të FUD - it e BUD - it, e deri marinarëve të thjeshtë, gjersa u arrit të ruhej nderi dhe të mbanim si pronë të ushtrisë tonë gjithçka na lejonte traktati mes dy vendeve, deri dhe atyre katër nëndetëseve. Përshtypje të pashlyera i lanë atij eprorët si generalin e papërsëritshëm Petrit Dume, shpirtmadhi Rrahman Parlaku, i mençuri Vaskë Gjino, admiralin i ditur Abdi Mati, drejtori Politik Hito Çako, Kapitenin e Rangut të Parë Hazis Hasa, kuadrot si Xhemal Zeneli, Gjergj Titani, Jonuz Mersinaj, Qemal Hate, Adem Jaupi, Spiro Kote, Novruz Zejnati, Petrit Gjonça, Shezai Osmani, Diktim Halili, Mexhit Çiku e plot të tjerë. Shërbeu kryesisht në ishullin e Sazanit dhe për këtë, nuk u ankua kurrë. Do ta gjeje përherë mes marinarëve, të përgatitja e timonierit, sinjalistit, radistit, mitralierit, minjorit, motoristit e deri kuzhinierit. Për më tepër, ai mori masa energjike edhe për krijimin e kushteve për jetesë, punësim, arsimim e argëtim edhe për familjet e oficerëve dhe nënoficerëve. Bëri çmos edhe për mbarëvajtjen e ekonomisë ndihmëse të reparatit. Vetë ishte i prirur edhe nga puna edukative e efektivit dhe ajo shkencore, pasi veçanërisht pas largimit të sovjetikëve, lindi nevoja për plotësime si nga ana e kualifikimit të kuadrove ashtu edhe e zëvendësimit të pjesëve të ndërrimit për anijet. Prandaj mori përsipër edhe përkthimin ose më mirë të themi, shqipërimin dhe përshtatjen e shumë rregulloreve të domosdoshme për Flotën Luftarake. Këto i duheshin edhe shkollës tonë të Marinës që u hap në Vlorë me djem të mrekullueshëm, me të cilët ai krijoi marrëdhënie të sinqerta epror - vartës, aq sa ata i dolën me vendosmëri në mbrojtje sa herë atë e sulmonte ndo-

(Vijon në faqen 5)

## PROFIL



In bring memory of  
Dik Cami  
(1905-1945)  
[www.fjalaelire.com](http://www.fjalaelire.com)

**Veprimtar i nacionalizmit shqiptar,  
Ushtaraku nga Dibra e Madhe që u  
pushkatua nga gjyqi "special" i Tiranës  
i 13 prillit të vitit 1945**

# Reformatori i ushtrisë shqiptare...

## Nga Sakip Cami

**Dik Cami (1905-1945)**  
**Reformatori i ushtrisë shqiptare që u  
pushkatua nga regjimi komunist**

U lind në Dibër të Madhe në vitin 1905. Ishte i biri i Mehmet Camit nga Dibra e Madhe, shtëpia e të cilit ishte vatër e atdhetarizmit shqiptar.

Stërgjyshi i tij Mane Cami ishte një nga organizatorët e luftës kundër Hajredin pashës në fushën e Gjoricës në vitin 1844. Çifligu i tij me toka prodhuese ishte në Gjoricë.

Kanga popullore e mbledhur nga Haki Stërmilli thotë:

"Dibër e male kuvendojnë  
Ne me mbretin pushkë do të bajmë

.....

Bajër Markja e Sheh Zerqani  
Janë mbledh' ke Mane Cami

.....

Një rrugë në Dibër të Madhe ku kishte shtëpinë, në shekullin 19 dhe 20 identifikohet me emrin e tij (Haki Sharofi, Historia e Dibrës Vëllimi I, faqe 98)

Mane Cami së bashku me të birin Halilin mbështetën Abdyl Frashërin në Kuvendin e Dibrës pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Kushëriri i Mehmetit, Shahin Demir Cami (1888-1972), antar i Klubit patriotik "Bashkimi" të Dibrës së Madhe, veprimtar i çështjes kombëtare është atetantori i prefektit turk Hysni pasha.

Kanga popullore thotë:

"Mu ke Ura e Selamit  
Vrau pashën Shahini i Camit  
Medet pashë seç të gjeti  
Në Dibër ty të gjet kjameti  
Dibra, jo, s'jep nizamë  
Janë ngrit' i gjithë mileti.

.....

Shahini familjarisht në vitin 1920 për t'i shpëtuar represionit serb largohet nga Dibra e Madhe për në Sepetovë të kushuriri i tij Dan Cami dhe më pas vendoset në Tiranë. Kushëriri tjetër Hamiti, anëtar i Klubit "Bashkimi" në vitin 1913 arrestohet nga serbët dhe nisat nën ruajtjen e dy ushtarve serb për në qytetin e Dibrës për t'u vrarë. Arrin ti vrasë serbët, e të largohet në anën tjetër të kufirit, tanimë të ndarë nga fuqitë e mëdha. Kushërinjte në anën tjetër të kufirit të ndarë padrejtësisht nga fuqitë e mëdha, Dan e Feta Cami me çetat e tyre nuk lejuan që serbët të realizonin qëllimet e tyre ekspansioniste për të marrë edhe pjesën e Dibrës në anën perëndimore të lumit të Drinit të Zi.

Pas vitit 1913 serbët filluan masakrat ndaj popullsisë shqiptare në Dibër të Madhe.

Ndaj Mehmeti me pesë djem, Halisin, Dilaverin, Sadikun, Mislimin dhe Menduin, të planifikuar për t'u shfarosur, u larguan me shpejtësi dhe fshehtësi për në Shqipëri, ku u sistemuan në Tiranë e në Durrës dhe u morën në tregëti.

Në Tiranë në vitin 1940 dy djem të Mehmetit banonin në Rrugën "Konti Ciano" dhe të tjerët në Durrës.

Mislimi gjatë kohës së Luftës së II Botërore kthehet në vendlindje. I biri Medati pasi mbaron Shkollën Normale të Elbasanit kthehet në Dibër dhe fillon punën si arsimtar.

Sadiku (Dika) ndoqi gjimnazin në Shkodër dhe më pas përfundoi Akademinë Ushtarake të Modenës në Itali dhe mori gradën nëntoger.

Dika u kthye në Shqipëri dhe filloi të shërbejë në Shkollën Ushtarake të oficerëve që sapo ishte krijuar dhe kishte nevojë për kadro të kualifikuara.

Dik Cami sëbashku me disa oficerë shqiptarë që kishin studiuar në Itali dhe me disa instruktorë të ushtrisë italiane ngritën dhe zhvilluan arsimin ushtarak në Shqipëri.

Pas pushtimit italian, Dika vazhdon shërbimin në

ushtrinë shqiptare. (AQSh, dosje e vitit 1940, shkresë e Komandës së Përgjithshme të Karabinierisë Italiane datë 29 gusht 1940)

Gjatë periudhës 1943-1944 Dik Cami punon në xhandarmërinë shqiptare në Durrës dhe në Kavajë me gradën toger.

Në Kavajë ai kishte shtëpinë e tij private dykatëshe me arkitekturë moderne që binte në sy, të cilën ja sekuestruan pas pushkatimit.

Si nacionalist dhe si ushtarak që kishte studiuar në Itali, ai ishte antikomunist, antibolshevik, antijugosllav.

Në raport me detyrën ai ishte i përpiktë në zbatimin e urdhërave të eprorëve.

Pas masakrës së 4 shkurtit 1944, të Tiranës, ai vëhet në dispozicion të prokurorisë së Durrësit për hetimin e kësaj masakre në zbatim të urdhërimit të qeverisë së kryeministrit Rexhep Mitrovica.

Dika ishte i martuar me Nazen, vajzë nga Durrësi, por nuk patën fëmijë.

Fill pas çlirimit, në prill të vitit 1945 pushteti komunist i sapo dalë nga lufta organizon gjyqin e hakmarrjes, gjyqin special ushtarak për ekzekutimin dhe dënimin e kundërshtarëve dhe të atyre që kishin bashkëpunuar me okupatorët.

Gjyqi kryesohej nga Gjeneral Lejtant Koçi Xoxe, i preferuari i jugosllavëve.

Gjyqi dënoi me pushkatim 17 ish ministra kuislinga, deputetë, ushtarakë të lartë si dhe me burgim dhjetra të tjerë.

Me pushkatim u dënua edhe Dik Cami që nuk ishte as ministër e kryeministër kuisling, as ushtarak i lartë, as asamblist e as politikan.

Por Dik Cami ishte në listat e UDB jugosllave për tu ekzekutuar dhe ekzekutorë do të ishin bashkëpunëtorët e Jugosllavisë.

U arrestua në dhjetor 1944 dhe u pushkatua në prill 1945.

Sikurse Dik Cami u dënua edhe shumë shqiptarë të Dibrës e të Kosovës që luftuan për Shqipërinë Etnike.

Fjalët e tij para trupit gjykues ishin:

"Mbrapsht nuk kthehem se jam ushtarak. Vdes si shqiptar se gjithë jetën ia kam kushtuar Shqipnisë dhe organizimit të ushtrisë shqiptare.

Rroftë Shqipnia Etnike !

## Literatura:

1. Fjalori i krimeve të komunizmit Vëllimi I
2. P. Pepa "Dosja e diktaturës" Tiranë 2009, V 1 faqe 30
3. AQSh dosja e Dik Camit viti 1944
4. Haki Stërmilli "Dibra në prag të historisë" 2023 botim nga M&B
5. Haki Sharofi, Historia e Dibrës, 2004
6. Sakip Cami, "Fisi Cami i Dibrës", 2019
7. Fisnik Cami, biografia e të jatit, Medat Cami

## IZET VEÇANI HISTORIA E GJALLË E FLOTËS TONË LUFTARAKE

### (Vijon nga faqja 4)

kush me intriga. Se duhet thënë që këtë njeri dhe kuadër nga më të mirët, klima e kohës, shpesh nuk e la të qetë. I sajoni përgjegjësi për gabime të paqëna, por ai kurrë nuk u përkul. U ndesh me burokratët e K.Q. Partisë në Komisionin Qendror të Kontroll Revizionit, frikacakë e servilë të pashpirt. I thonin se ke punuar shumë mirë, por vuan nga intelektualizmi dhe mendjemadhësia të cilat janë sëmundjet më të rrezikshme për Partinë tonë. Hajde e merri vesh këto sofizma për një njeri që gjithë jetën shërbeu me trupa dhe atje ku vështirësitë ishin më të mëdha. Madje puna arriti që ta bënin fajtor edhe pse kishte debatuar me një Kapiten anije të huaj, pra edhe kur mbronte vijën politike të vendit tonë. Për këtë, atë djalin 14 vjeçar që ishte bashkuar me radhët partizane, atë skënderbegasin e dikurshëm, atë studentin që kishte mbaruar shkollat jashtë dhe brenda vendit me rezultate të shkëlqyera, pra atë kuadrin që kishte fituar zemrat e vartësve dhe kolegëve me aftësitë, përkushtimin dhe ndershmërinë e tij, e shpallnin të padëshiruar dhe e lironin nga ushtria. E çuan lulishtar, atje në rrugën e Skelës, ku atë e njihnin të gjithë. Por ai nuk e uli asnjëherë kokën deri sa doli në pension. Ndaj edhe

sot në moshën 96 vjeçare atë e respekton dhe e nderon një qytet i tërë. U ndamë me të dhe shkua për vizitë në Zvërnec, me qenë se atë vend nuk e kishin parë shokët tanë Gëzim Agasi dhe Stavri Havale, ku pasi ishte shpallur "armik", ishte internuar për një kohë të gjatë edhe ai gjenerali i famshëm, Gjijn Marku, komandanti i dikurshëm i Brigadës partizane, ku Izeti kishte kryer fillimisht detyrën e korrierit.



## DOSSIER

Ndëshkimi i padrejtë pse lejoi botimin e të ashtuquajturave "teza të zeza" në organin teorik të Ministrisë së Mbrojtjes

# "TEZAT E ZEZA TE BALLUKUT", SI U PËRJASHTUA NGA USHTRIA DEKANI MUJO SOKOLAJ

• JETA PLOT TALLAZE E MUJO SOKOLAJT, NGA BURGU POLITIK I PRISHTINËS DERI DEKAN I FAKULTETIT GJITHARMËSH NË AKADEMINË USHTARAKE

Mujo Sokolaj është padyshim një nga personalitetet e shquara që zë vend nderi në historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të Ushtrisë Shqiptare. Ai iku për në botën e përtejme, pesë vjet më pare, kur i duheshin edhe vetëm disa muaj për të kapur një shekull jetë. Afro një shekull jetë e trazuar, por dhe me histori të lavdishme e një emri të spikatur, si legjendë qëndrese e tri kohëve. Mjafton të shfletosh ditaret që ai i la të shkruara, si amanet për brezat që do vijnë, përshkrimin në to të ngjarjeve e datave historike, që nga Operacioni Armik i Dimrit 1943-'44 e deri te artikujt studimorë e shkencorë të revistës "Njohuri ushtarake" (organ teorik për përdorim të brendshëm i Ministrisë së Mbrojtjes) që ai e drejtonte si kryeredaktor në vitin 1971, për të konkluduar për përmasat shumëdimensionale të këtij ish luftëtari e qëndrestari të paepur dhe intelektualit të mirëfilltë, që gjithë jetën ia kushtoi atdheut e kombit.

Nga një vështrim sipërfaqësor i dosjes së tij mësojmë për jetën plot tallaze të një strategu të luftës e ushtrisë, nga arrestimi e qëndresa në burgun politik të Prishtinës më 1943 e deri tek ndëshkimi i padrejtë pse lejoi botimin e të ashtuquajturave "teza të zeza" në organin teorik të Ministrisë së Mbrojtjes.



**NXËNËSI I SHKOLLËS AMERIKANE QË VENDOSI LIDHJET ME KOMITETIN LOKAL TË PRISHTINËS**

Mujo Sokolaj që kishte lindur në Dragobi të rrethit Tropojë më 21 qershor 1919, vinte nga një familje me tradita patriotike dhe liridashëse, me kontribute të mirënjohura në krahinën e Krasniqes dhe Gashit (nip i Ajdin Bajraktarit, Halil, Haxhi dhe Zenel Brahimit). Shtëpia ku u lind ishte djegur 3 herë nga serbët, ndërsa i ati invalid



për shkak të plagëve të marrë në luftë me serbët.

Mungesa e nënës (jetim që 5 vjeç), pamundësia e babait për t'i siguruar të birit minimumin jetik për shkak të plagëve e detyroi 8 vjecarin të linte fshatin dhe në mes të dimrit të acarrit të merrte në këmbë rrugën e vështirë për te daja i tij (Ajdin Bajraktari) i cili në atë kohë ishte oficer në Kukës. Që nga kjo kohë familja e dajës u bë përjetë familja e tij dhe marrëdhënia dajë e nip, një histori e rrallë, jo thjesht familjare, por marrëdhënie shokësh lufte që do ti ndante vetëm vdekja. Në Kukës filloi shkollën flore (5 vjeçare) të cilën e përfundoi me rezultate shumë të mira në Shkodër për shkak të transferimit të dajës në atë qytet.

Pasi fitoi konkursin (në matematikë dhe gjuhë shqipe) në Shkodër Ministria e Arsimit e kohës i komunikoi të drejtën e shkollës dhe bursën për Shkollën Teknike (Ish shkolla amerikane, "Fullci") në Tiranë. Bursa nuk i plotësonte nevojat bazike dhe detyrohej të punonte te dielave në fermën e shkollës.

Me pushtimin fashist degë të shkollës Teknike të Tiranës u transferuan në Golem dhe Korçë madje duke ia ndruar dhe emrin), të cilën e përfundoi në qershor 1942 në Golem Kavajë

Gjatë periudhës së shkollimit u përfshi që ditët e para të prillit 1939 në lëvizjen e gjërë të studentëve të shkollës teknike të Tiranës për të kundërshtuar përgatitjen e pushtimit ushtarak të Shqipërisë nga Italia fashiste dhe ishte pjesëmarrës aktivë në lëvizjen e antifashiste të shkollës në Golem dhe bashkëpunoi me grupet e rezistencës në Durrës.

Në korrik 1942 fitoi konkursin dhe filloi kursin pedagogjik të shkollës Normale të Prishtinës, ku përgatiteshin mësues për nevojat e Kosovës. Në kurs kishte rreth 80 studentë nga trevat

shqiptare përgjithësisht me pikëpamje përparimtare dhe patriotë.

Me porosi nga organizata e Durrësit vendosi lidhjet me komitetin lokal të Prishtinës. Këtu njihet e bashkëpunon me Emin Durakun, Xheladin Hanën, Javer Malon etj.

Më 17 tetor 1942 emërohet me dekret të Ministrisë së Arsimit "mësues", në Hoxhe të Madhe, në Rahovec të prefekturës së Prizrenit, në Dule të Suharekës, në Obiliq, Slivovë të Ferizajt, ku vendos lidhje me Xhevdet Dodën. Mes të tjerave Kuestura në Prizren u njoftua se mësuesi (Mujo) nuk lejonte që nxënësit në klasë të përshëndesnin në mënyrë fashiste kur mësuesi hynte në klasë.

Paralajmërimet nga autoritetet zyrtare shoqëroheshin me transferime të shpeshta nga një shkollë e katund në një tjetër për shkak të veprimtarisë kundër pushtuesit. Ndërkohë kish vendosur lidhjet me drejtuesit e Komitetit Krahinor të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit. I ngarkuar nga ky komitet siguroi bazën materiale për çetat "Emin Duraku", "Zenel Ajdini" dhe atë të Ferizajt si dhe mori pjesë në disa aksione.



**SI I SHPËTOI EKZEKUTIMIT NGA BURGU POLITIK I PRISHTINËS**

Në prill 1943 Mujo Sokolaj cilësohet element i dyshimtë dhe i padëshërueshëm dhe dëbohet nga Kosova dhe pas 10 ditësh arrestohet me urdhër të kuesturës së qarkut të Prishtinës. Mospranimi i akuzës për veprimtari kundër shtetit pasoi me dy javë tortura të rënda dhe dërgimin në burgun e Prishtinës si i burgosur politik. Ndërkohë në Prishtinë shkon dhe vendimi në mungesë i gjykatës së Tiranës që e dënonte me 30 muaj burg.

Pas 8 shtator 43 burgu Prishtinës kaloi nën kontrollin e pushtuesit gjerman dhe pak para ekzekutimit të grupit të burgosurve politikë ku

ndodhej edhe Mujo erdhi njoftimi i amnistisë së përgjithshme për të burgosurit nga qeveria e Tiranës.

Nga burgu shokët e dërguan në bazën ilegale në Prizren dhe më pas në Komitetin Krahinor dhe Shtabin kryesor të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit ku ngarkohet me detyrën e mbajtjes së lidhjeve me lëvizjen në Shqipëri dhe informimit për kërkesat e saj.

Bashkëluftëtarët e kujtojnë si një ndër organizatorët e aksionit të Landovicës së bashku me Gani Goxhin, Astrit Lekën, Hasan Vokshi etj .

**NGA KONFERENCA E BUJANIT DERI TEK LUFTIMET NË SANXHAK**

Në vjeshtë '43, Mujo Sokolaj caktohet nga Komiteti Krahinor i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit për të marrë pjesë ilegalisht në Lidhjen II të Prizrenit. Për punimet e kësaj mbledhje Mujo vuri në dijeni Fadil Hoxhën, Vasil Shanton (veliun) në Shkodër, Gogo Nushin (hysenin) Abdyl Këllezin në Tiranë dhe Xhaferr Spahiun.

Në 26 nëntor 1943 u dha urdhëri

për arrestim të dytë dhe në këto rrethana, nga dhjetori 1943 kaloi në ilegalitet të plotë.

Gjatë kësaj kohe iu ngarkua detyra për përgatitjen dhe dërgimin e delegatëve të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit në Konferencën e Bujanit. Në pamundësi për të vijuar më tej për shkak të rrezikut të arrestimit me ndihmën e Shaban Shpatit çan postbloquent e ngritur për arrestimin e tij dhe fshihet në Gjakovë. Pas pak ditësh 45 partizanë e shoqëruan në batalionin "Bajram Curri" dislokuar në Degë të Tropojës. Pas takimit me Shpend Degën, Sadik Bekteshin dhe Shaban Haxhinë, një letër nga Fadil Hoxha, komandant shtabi i Kosovës,

(Vijon në faqen 7)

## DOSSIER



(Vijon nga faqja 6)

i kërkonte të shkonte urgjentisht atje, ku u ngarkua të shkonte në Mal të Zi për të njohur me situatën dhe në kthim mori pjesë në analizën që shtabi operativ i Kosovës i bëri operacionit të dimrit 1944 në Tropojë. Bashkohet me batalionin Bajram Curri, merr pjesë në disa aksione në rrethin e Tropojës me shokët e tij si dhe iu ngarkua detyra për të marrë pjesë në mbledhjen e Zarishtes afër Vaut të Spacit në Has, organizuar nën ndikimin e misionit ushtarak anglez.

Luftimet në Plavë e Guci korrik 1944 e gjejnë komisar në çetën partizane "Shkëlzeni", që iu bashkangjiten edhe Bije Vokshi e Zeqirja Rexha dhe me të cilët uajti një miqësi me dekada,

Me krijimin e Brigadës 25-të S, në kuadër të Divizionit të V-të S mori pjesë në veprimet luftarake për çlirimin e Tropojës, Shalës, Dukagjinit, Pejës, Ferizaj, Liplan, Prishtinë Mitrovice, Rashkë, Novi Pazar, Senicë (Sanxhak), Priepolje.

#### STUDENTI I SHKËLQYER NË "VOROSHILLOV" DHE "FRUNXE" NË MOSKË

Në qershor 1945 Mujo Sokolaj caktohet komisar i rrethit Tropojë. Punoi për vendosjen e rendit dhe qetësisë si dhe bëri përpjekje për bindjen e popullsisë për dorëzimin e armëve. Vështirësitë ishin të mëdha dhe rreziku e shoqëroi gjithë kohën. Madje ish bashkëpunorët e fashizmit e dënuan me vdekje.

Tranferohet në Tiranë dhe caktohet instruktor i përgatitjes ushtarake në shkollën e Bashkuar.

Në harkun kohor qershor 1946 - tetor 1949 kryen Ucilishcën e lartë "Voroshilov" në Odesa për përgatitje ushtarake këmbësori gjitharmësh. Me mbarimin e shkollës caktohet Instruktor dhe zvshef dege në drejtorinë politike, deri më 1 maj 1950 kur caktohet Komisar i Regjimentit të 29 të Divizionit të I-rë, i drejtuar nga deri në atë kohë nga Hajdar Arانيتasi. Për katër vitet në vijim (1953-1957) keu me devotshmëri e përkushtim detyra e funksione të larta, si: shef i degës politike në Repartin 1105 në Tiranë dhe pastaj në Brigadën e



I-rë; ndihmës shef i degës operative në MMP dhe zv shef i degës së parë në drejtorinë operative.

Nga 23 shtator 1957 deri në korrik 1960 Mujo Sokolaj kryen me rezultate të shkëlqyera Akademinë ushtarake "Frunxe" në Moskë, një nga akademitë më të njohura të kohës për përgatitjen e oA cerëve madhorë.

Për 7 vjet në Drejtorinë e parë, zëvendës shef dhe shef i degës së shtabeve në MMP për përgatitjen operative të shtabeve dhe oficerëve madhorë për strukturat e ushtrisë shqiptare, së bashku me shokët e tij do të projektonte stërvitjet më të mëdha e më të vështira të ushtrisë shqiptare që cuan në aftësimin ushtarak në shkallë të lartë të Forcave të Armatosura.

Ish studenti i shkëlqyer i Ucilishcës së lartë "Voroshilov" dhe akademisë ushtarake "Frunxe" në Moskë, pas një përvoje të vyer në funksionë të larta të njërive e Ministrisë së Mbrojtjes, më 1967 emërohet Dekan Fakulteti Gjitharmësh në Akademinë Ushtarake, ku aftësoheshin ushtarakët madhorë të ushtrisë. Pas tre vitesh (më 1970) profesori i mirënjohur kalon në Institutin e Studimeve Ushtarake, ku së bashku me kolegë të tij mendohej se do të thellonin studimet teorike ushtarake me qëllim përsosjen e modernizimit të ushtrisë.


Në vitin 1971 Mujo Sokolaj do t'i besohet drejtimi si kryeredaktor i revistës "Njohuri ushtarake" organ

# "TEZAT E ZEZA TE BALLUKUT", SI U PËRJASHTUA NGA USHTRIA DEKANI MUJO SOKOLAJ

teorik për përdorim të brendshëm i MMP, me volum deri 300 faqe, me një tirazh shumë të kuA zuar, 4 numra në vit (nën kujdesin e institutit, autonome prej tij e varur nga Shtabi i Përgjithshëm). Me ngjarjet e ushtrisë në vitin '74 edhe Revista iu nënshtrua revizionimit të thellë dhe kërkesës së logarisë për botimin e të ashtuquajturave "teza të zeza". Në këto rrethana, më 18 dhjetor 1974 Mujo Sokolaj shkarkohet nga detyrat me urdhër dhe nuk mund të punonte në ushtri. I gjithë kontributi i luftëtarit, strategut e i shkencëtarit ushtarak që ishte vlerësuar me 17 dekorata,

urdhra, medalje, nga 1 janar 1980 "shpërblehet" nga nomenklatura e kohës me pension të detyruar minimal, të parakohshëm. Si edhe personalitete të tjera ushtarake të asaj plejade, pas masave represive ndaj të ashtuquajturit "grup puçist" e pasardhësve të tyre, edhe Mujo Sokolaj, për një kohë u shoqërua me survejim dhe thirrjet në hetuesi për ngjarjet në ushtri.

Gjithsesi ai mbeti simbol e përçues i vlerave më të mira njerëzore, duke iu përkushtuar familjes e shoqërisë, deri në momentet e fundit të jetës së tij.



## HISTORIA

*Ish partizani i brig.18 S që u plagos në provokacionet greke të 1949-tës*

# RIZA GJOKA, KRENARI E DARDHËS DHE DIBRËS



**Nga Muharrem GJOKA**

**Nënkryetar i OBVL**

**Mjeshtër i Madh**

ZALL-DARDHA që njihet për bëmat e burrave të saj në historinë shumëshekullore, për trimërinë e tyre në kryengritjet e armatosura kundër turqve, serbve e nazifashistëve italianë e gjermanë, por dhe për artistët e shumtë që me aftësitë e tyre krijuese e interpretuese, janë bërë pasaporta e identitete të Dibrës e jo më të Dardhës, njihet në histori edhe për një institucion të veçantë popullor, për Kuvendin e “15 burrave të dheut”. Të “15-tët e dheut” ose siç mund të quhet një “Kuvend – Parlament” i Dardhës përbëhej me përfaqësues të denjë me integritet, si: Hysen Ndreu, Hysni Kaca, Hysen Bara, Hysen Çera, Misim Ahmeti (Cerpja), Can Gjoka, Rrahman Rasha, Ahmet Kaziu, Vesel Sula, Muharrem Hoxha, Taf Shira, Ali Bajram Ndreu, Sul Cani, Met Kaca, e Selim Hysa.

Siç sihet, në këtë 15-shte është dhe një përfaqësues i fisit Gjoka, emrin e ndritur të të cilit do ta lartësojnë ndër vite pasardhës të denjë të tij. Njëri prej tyre, padyshim është Riza Gjoka, i cili që në moshën 15-vjeçare do të radhitej si partizan në brigadën e 18-të Sulmuese dhe do të merrte pjesë trimërisht në të gjitha luftimet e kësaj brigade, nga data e krijimit e deri në çlirimin e plotë të atdheut nga pushtetist nazifashistë më 29 nëntor 1944.

## 15 VJEÇ PARTIZAN NË BRIGADËN E 18-TË SULMUESE

Riza Gjoka, djali i parë i bashkëshortëve Rushit e Hane Gjoka (Kaca) lindi në lagjen “Gjokaj”, Zall Dardhë më 5 Maj 1928. Fëmijërinë, deri në moshën 9-vjeç e kaloi në fshat dhe pikërisht pa mbushur 10 vjeç, për të ndihmuar familjen që ishte në gjendje të vështirë ekonomike, i shoqëruar dhe nën përkujdesjen e xhaxhait të tij, Mediut shkon të punojë si argat në një familje tiranase (në Tiranë). Këtu, dy motra të veja që kishin dy djem dhe një dyqan në Selitë (sot Qyteti i Nxënësve) do ta trajtonin Rizain shumë mirë, ku përveçse si ndihmës në dyqan dhe në punët e shtëpisë e dërgonin edhe në shkollë. Madje, falë zgjuarsisë së tij natyrale, nga kontakti me italianët që blinin cigare në dyqanin ku punonte, Rizai mësoi të fliste edhe italisht.

Njëri nga djemtë e familjes ku banonte kishte rënë në kontakt me Njësitë

Guerile dhe nga ai, djaloshi nga Zall Dardha mësoi për herë të parë për Luftën Nacionalçlirimtare. Me kapitullimin e Italisë dhe burgosjen e djalit të familjes ku banonte e punonte, pas një rrugëtimit të vështirë që zgjati dy-tre ditë kthehet pranë familjes. Tashmë ishte më i pjekur dhe i edukuar me virtyte të patriotizmit e të dashurisë për atdheun. Ngaqë e urrente pushtuesin, që ndër të parët e bashkmoshatarëve të tij që rroku pushkën e u radhit me formacionet partizane të Brigadës së 18-të Sulmuese. Bashkohësit e kujtojnë atë si djaloshin trim që hidhej me guxim në aksionet luftarake të kësaj brigade. Si i tillë ai do të ishte i ftuar nderi në çdo përvjetor të çlirimit të Peshkopisë (23 gusht), i dekoruar me Çertifikatat e Medaljet e Trimërisë e të Kujtimit.

## SHOFERI I PARË I DIBRËS, INSPEKTOR POLICIE NË DISA ZONA

Riza Gjoka ishte vetëm 18 vjeç kur u angazhua në Policinë e Shtetit. Kjo periudhë koinçidon me sulmin e paprecedentë të kufirit tonë shtetëror, të njohur në histori si Provonacioni Grek i 1949-tës. Për t'i bërë ballë këtij agresioni, si dhjetra dibranë të tjerë edhe Rizai dërgohet në fshatrat midis Korçës dhe Kolonjës, ku angazhohet në ndihmë të ushtrisë për zbulimin e pozicioneve greke.

Gjatë një sulmi me artileri u plagos rëndë në këmbë e kokë dhe mbeti pa ndjenja. Për një periudhë 5-6 javore u mjekua në spitalin e Korçës. Shpesh në familje ai tregonte shenjat e dukshme të plagëve në gjurin dhe kaviljen e djath-të dhe në faqe. Gjithsesi, edhe në këtë gjendje Rizai nuk hezitoi të ngjiste shkallët e karrierës, fillimisht në Degën e Brendëshme Peshkopi si inspektor në zonat Kastriot, Slllovë, Muhurr etj, e deri punonjës në Ambasadën e Shqipërisë në Ankara.

Ai do të ishte shoferi i parë i Dibrës dhe pasi kishte kryer me rezultate të shkëlqyera edhe arsimin e mesëm, do të shërbente si i tillë në dispozicion të ish kryetarit të DPB Banush Goxhaj.

## ME TRUPIN DIPLOMATIK SHQIPTAR NË ANKARA

Në fillim të vitit 1958 Rizai ndoqi në Tiranë kursin ku përgatiteshin personeli dhe Trupi Diplomatik. Në vjeshtën e vitit 1959 deri në fund të vitit 1962 ai ishte punonjës në Ambasadën e Shqipërisë në Ankara. Për atë periudhë Rizai tregonte mbresat nga shoqërimi i të gjitha delegacioneve zyrtare shqiptare dhe veçanërisht nga koha kur shoqëronte Ansamblin Shtetëror të këngëve dhe Valleve. Për të mbetej e paharrueshme pritja emocionuese që shqiptarët e Turqisë u rezervuan artistëve tanë, këngëtareve Fitnete Rexha e Naile Hoxha, valltarit Besim Zekthi e të gjithë artistëve të këtij Ansambli. “Edhe unë, si bir i Dardhës, trevë e aristëve me emër, do të mahnitësja me performancën e valltarit të shqipeve Besim Zekthi. Ky Mjeshtër i valles popullore shqiptare, valltar solist i pakrahasueshëm i Ansambli të Këngëve dhe Valleve Popullore, shkëlqeu gjatë shfaqjeve në Ankara, veçanërisht në vallet e epikës legjendare duke performuar me shpirt dhe hijeshi të veçantë eposin



**RIZA GJOKA**

shqiptar”, tregonte Rizai.

Pas përfundimit të misionit pranë Trupit Diplomatik të Shqipërisë në Turqi, Riza Gjoka kthehet në Tiranë ku u la në dispozicion për një detyrë të re.

## SHËRBIMI I SHEF I INSPEKTORIT RRUGOR DHE NËNDREJTOR I PARKUT TË MALLRAVE DIBËR

Për burrin e shquar të Zall Dardhës dhe gjithë Dibrës, i cili në vitin 1956 ishte njohur dhe martuar me bashkshorten Ismete Gjoka (Biba), me të cilën do të sillnin në jetë pesë vjaza: Donika, Fatbardha, Vola, Shpresa, vdekja e njëres prej tyre në moshën 4-vjeçare që një ngjarje e rëndë që shënoi një pikë kthese. Kjo traumë në familjen e tij bëri që ai të marrë vendimin të qëndrojë në Shqipëri. Kështu, Riza Gjoka, vëllai i madh i tetë fëmijëve të Rushit e Hane Gjokës: (tre vëllezërve Halit, Mexhit e Xhemal dhe katër motrave, Veza, Nurija, Haza dhe Adivija) dhe babai i katër vajzave të mrekullueshme (që sot kanë krjuar dhe u gëzohen familjeve të tyre) do të ishte mbështetja kryesore dhe udhërrëfyese i tyre, (si dhe i gjithë farefisit, në raste gëzimesh e hidhërimesh).

Karriera e tij vijon si Shef i Inspektoriatit Rrugor në Kukës ku punoi dhe në përgatitjen e inspektorëve të rinj rruqorë. Pas largimit nga Kukësi erdhi në

Peshkopi me detyrë Inspektor Rrugor në Degën e Brendëshme.

Pas 30 vitesh punë, lirohet me dëshirë nga shërbimi policor për t'ju kthyer jetës civile. Sërisht në një funksion të rëndësishëm si nëndrejtor i Parkut të Mallrave Dibër, ku me talent e përkushtim të rrallë bëri që ky Park të renditej ndër më të mirët në rang vendi. Punoi edhe për disa vite si shofer në transportin ndërkombëtar në ish-Jugosllavi, Çekosllavaki, Hungari, Poloni, Bullgari etj.. Doli në pension si kontroll teknik i automjeteve pasi mosha kishte bërë të veten.

## KRENARIA PËR VENDLINDJEN

Riza Gjoka, në oda e mexhelise burrash, si dhe me fëmijët, gjithë fliste me krenari për vendlindjen e tij, Zall Dardhën, si djep i trimërisë, burrërisë. artit, muzikës e kulturës. Kishte shpirt artistit. Këndonte, kërcente dhe i binte sharkisë shumë bukur. Ai që një përfaqësues i denjë i Zall Dardhës, mishërues dhe përçues i vlerave e virtyteve më të mira tek të cilat besoi dhe jetoi me to. Prandaj dhe nderohet e respektohet jo vetëm nga familjarët, të afërmit e miqtë, por edhe nga bashkëpunëtorët dhe nga të gjithë ata që e njihnin. Pas një sëmundje të rëndë ai u nda nga jeta më 14 shkurt 2009, duke mbetur në kujtesën tonë si njëri model në të gjithas drejtimet.



## 7-MARSI

Mësuesi i dinjitetshëm që vlerësohet, respektohet e nderohet si veteran shembullor i arsimit

## NDERIMI PËR MËSUESIN VETERAN MENTOR DOMAZETI

- Për 45 vjet, si edukator i mijëra nxënësve ai ka dhënë shembullin më të mirë në shkollat ku punoi, duke krijuar modelin e mësuesit e drejtuesit që duhet të ndjekin brezat



Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Sa herë vjen 7- Marsi, gjithkush kujton me nderim dhe respekt të veçantë mësuesit e tyre, veçanërisht ata të viteve të fëmijërisë që ju mësuan shkronjat e veprimet e para aritmetike, por dhe zgjidhjen e ushtrimeve e teoremave të algjebërës, gjeometrisë e fizikës. Për këto të fundit, që njihen si lëndë të shkencave ekzakto, unë si dhe dhjetra bashkmoshatarët e mi nga Muhurri: Liman Berisha, Shefqet Mikli, Haki Xhani, Shefqet Xhani, Shefqet Tanushi, Aqif Mikli, Femi Balla, Demir Rama, Marie Balliu, Flutura Kurti, Maliq Lleshi, Basri Zhuzhi, Ibrahim Doda e dhjetra të tjerë, edhe pas 46 vitesh i shprehim mirënjohje e admirim të veçantë mësuesit tonë të dashur Mentor Domazeti.

Ai ka lindur në fshatin Brezhdan të Dibrës më 30 maj 1948. Po këtu mbaroi shkollën 7-vjeçare në vitin 1962. Më tej vazhdoi studimet në gjimnazin e Durrësit nga ku u diplomua në vitin 1965.

I etur për arsimin e dije, Mentor Domazeti nuk do të mjaftohej vetëm me një diplomë gjimnazisti, por do të vazhdonte studimet e larta për matematikë-fizikë në Institutin (sot Universiteti) “Luigj Gur-



akuqi”, Shkodër. Pas diplomimit me rezultate të shkëlqyera do të provonte emocionet e mësimdhënësit në shkollën e fshatit të vendlindjes ku shërbeu me zell e përkushtim të rrallë në harkun kohor të pesë viteve (1967-1972). Ligjet e asaj kohe do t’ja ndërprisnin përkohësisht karrierën e mësuesit për të vijuar kryerjen e shërbimit të detyruar ushtarak.

Rikthehet sërish në arsim, këtë radhë një orë larg vendlindjes si mësues i matematikë-fizikës në shkollën 8-vjeçare “Nexhat Agolli” Muhurr (pas disa vitesh e Mesme e Bashkuar), ku shërbeu për rreth dy dekada, (nga janai 1975 deri në qershor 1993).

Këtu u mësoi lëndët e shkencave ekzakto mijëra nxënësve muhurrakë,



qindra prej të cilëve mbaruan shkollat e larta në degë të ndryshme dhe sot shërbejnë si mësues, inxhinierë, mjekë, ushtarakë etj, në të gjithë vendin. Dhe jo vetëm nxënësit por dhe prindërit e tyre muhurrakë, me të cilët krijoi marrëdhënie afërsimtare e respekti të ndërsjellë, edhe sot e ndërojnë e respektojnë Mentor Domazetin si mësuesin shembullor që ia rriti prestigjin shkollës së Muhurrit. Kjo për faktin se asnjëherë nuk u konfontua me ta, përkundrazi kaloi me ta plot 18 vite në harmoni dhe paqe. Më 1994 mësuesi Mentor emërohet Drejtor i Shkollës në Katund të Ri të

Luznisë, ku për dy vite, me përkushtim, vizion bshkkohor e talent të rrallë bëri që ajo të renditej ndër shkollat më të mira të rrethit të Dibrës.

Katër vitet në vijim 1996-2000, Mentor Domazeti punon po në mënyrë shembullore si punonjësi i arsimit në komunën Tomini. Kariera e tij si mësues e drejtues përfundon në vitin 2012 pas 12 vitesh (2000-2012) përkushtimi e talenti të rrallë si mësues i matematikës në Shkollën 9 – vjeçare “Demir Gashi” të qytetit të Peshkopisë.

Breza të tërë nxënësish nga Brezhdani, Muhurri, Katundi i ri e Peshkopia e nderojnë, respektojnë dhe shprehin admirim për Mentor Domazetin, si ezelen në mësimdhënie e sjellje shembullore në komunitetet e tyre.

Këtë 7 Marsi, Ditën Mësuesit, është një moment i rëndësishëm që ne ish nxënësit e tij të shprehim respektin, nderimin dhe vlerësimin për kontributin që ka dhënë mësuesi Mentor Domazeti në edukimin dhe arsimin e brezave dhe në zhvillimin e shoqërisë sonë. Pasi edhe sot, në moshën 76 vjeçare (në pension) Ai nuk nguron t’u gjendet pranë, jo vetëm nipërve e mbesave, por edhe kujtudo nxënësi për t’ia lehtësuar mësimin e lëndëve të matematikës e fizikës. Nisur nga përvoja e tij dhe veçanërisht nivelin në të cilin ndodhen sot shkollat në zona të tëra të shpopullurara, Mentor Domazeti apelon që roli i mësuesit mbetet kyç në vënieën e shoqërisë sonë në binarët e zhvillimit dhe prosperitetit.

Gjithsesi ai ndjehet krenar që si gjithë mësuesit e brezit të tij, me kontributin real, sakrificat e panumërta dhe angazhimin e përkushtimit ndër vite i ka dhënë vulën proceseve nëpër të cilat ka kaluar shkolla shqiptare në 50 vitetë fundit. Pikërisht për këto merita të padiskutueshme Mentor Domazeti vlerësohet si mësuesi i dinjitetshëm, si veteran shembullor i arsimit. Për 45 vjet, tij si edukator i mijëra nxënësve ai ka dhënë shembullin më të mirë në shkollat ku punoi, duke krijuar modelin e mësuesit e drejtuesit që duhet të ndjekin brezat.

Këtë 7 Mars, nga zemra i uroj mësuesit tim Mentor Domazeti: “Gëzuar, ditën e nderimit të madh të veprës suaj të ndritur. Mirënjohja, dashuria e respekti do ta shoqërojnë përjetësisht punën dhe misionin tuaj fisnik”.

### 7 MARS – SI LINDI FESTA E MËSUESIT DHE HISTORIA E SAJ

7 Marsi, njihet si festa e Mësuesit në Shqipëri, dhe festohet në gjitha shkollat dhe universitetet.

Është një ditë simbolike për të kujtuar e vlerësuar mësuesit për përkushtimin e tyre në mësimdhënie dhe në përgatitjen e brezave të ardhshëm.

Zanafilla e kësaj dite përkon me hapjen e mësonjëtores së parë shqipe, e cila u hap në Mars të vitit 1887 në Korçë, pikërisht në një kohë kur shqiptarët mësonin shqip fsheturazi në shtëpitë e tyre, për shkak të sundimit Osman.

Mësonjëtorja e Korçës ka qëndruar e hapur për të paktën 20 vite dhe drejtues të tij ishin figurat e shquara të Rilindjes shqiptare si Pandeli Sotiri, Petro Nini Luarasi, Nuçi Naçi, Thoma Avrami e të tjerë.

Festa e 7 Marsit, u përforcua më shumë gjatë periudhës komuniste. Ajo ishte dita më e shënuar për mësuesit. Ishte një traditë e bukur, kur nxënësit zgjidhnin përfaqësuesit e tyre më të mirë, të cilët shkonin për vizitë në shtëpinë e mësuesit. Mësuesi i priste me gjithë të mirat, me ëmbëlsira e fruta, ndërsa dhuratat e nxënësve ishin shumë simbolike: lule ose libër.

Sot kjo traditë ka ndryshuar. Festa e mësuesit organizohet në shkollë, me koncerte dhe aktivitete të ndryshme. Edhe dhuratat janë më të larmishme, jo thjesht lule.

Deri në fillim të viteve ‘90 në Shqipëri, për të nxitur mësimdhënieën e një cilësie sa më të lartë, mësuesit më të dalluar shpërbleheshin me dekoratat e larta që ishin Mësuesi i Merituar dhe Mësuesi i Popullit.

#### Historia e Mësonjëtores së parë Shqipe

Në vitin 1885, Naim Frashëri, si zyrtar në Ministrinë e Arsimit në Stamboll, me të vëllain, Sami Frashërin dhe shqiptarë të tjerë me ndikim të “Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip”, ia dolën të siguronin lejen nga Sulltan Abdylhamidi II për hapjen e një shkollë shqiptare për djem në Korçë. Mbështetja financiare iu mundësua edhe nga mërgata e Rumanisë, anëtarët e Shoqërisë “Drita” të Bukureshtit, ndërsa shqiptarët e Stambollit vendosën që drejtor të shkollës të ishte Pandeli Sotiri. Mjedisi ku shkolla u vendos ishte shtëpia e dhuruar nga Diamant Terpo. Si “Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip”, ashtu edhe shoqëria “Drita” kishin rënë dakord që më përpara për të mos antagonizuar parinë vendase të ndikuar nga kultura greke duke hapur shkolla shqipe. Patrikana e Stambollit refuzoi që të jepej gjuha shqipe në shkollat ekzistente greke të komunitetit ortodoks të Korçës. Sotiri u dërgua në Korçë dhe e çeli shkollën më 7 mars 1887.

Tekstet e shkollës i mundësonin vëllezërit Naim e Sami Frashëri dhe shumë shqiptarë të tjerë.[8] Përgjatë 1887-ës, Sotiri iu desh të linte Korçën dhe administrimi i shkollës i kaloi Petro Nini Luarasi dhe Thanas Sinës. Autoritetet osmane i dhanë leje vetëm të krishterëve shqiptarë të ndiqnin mësimdhënieën në këtë shkollë, por shqiptarët nuk iu bindën lejes dhe lejuan fëmijët myslimanë që të mund ta ndiqnin. Vitet e para, në shkollë u regjistruan rreth 200 nxënës të besimit mysliman dhe të krishterë. Në vitin 1888, shkolla kishte 100 nxënës të krishterë dhe 60 myslimanë.

Pandeli Sotiri e filloi mësimin fillimisht me 35 nxënës. Hapja e kësaj shkollë për nga karakteri kishte tipare demokratike, pasi në të mësonin fëmijët e të gjitha shtresave, të varfër e të pasur. Kjo shkollë kishte një klasë përgatitore si dhe katër klasa të rregullta. Lëndët mësimore ishin shkrimi, këndimi, gramatika e gjuhës shqipe, historia, gjeografia, aritmetika, dituria natyrore dhe edukimi fizik.

Edhe pse në kushte të vështira, kur ndalohej rreptësisht mësimi i gjuhës shqipe për shkak të kushteve të ndodhura nën sundimin osman, mësonjëtorja e Korçës qëndroi e hapur për 15 vjet; u mbyll në vitin 1902, për t’u riçelë në vitin 1908. U mbyll përsëri në vitin 1912 dhe u çel pas pesë vjetësh në 1917-ën. Përkrahës të saj ishin figura të njohura të Rilindjes shqiptare, si: Naum Naçi, Thoma Avrami, Familja Qiriazi etj.

Më 15 tetor 1891, Gjerajim Qiriazi së bashku me të motrën Sevasti Qiriazi hapën këtu edhe Mësonjëtores e vajzave, baza e së cilës ishte gjithashtu gjuha shqipe dhe kultura kombëtare. Kontributi i madh që këta atdhetarë dhe veprimtarë të shquar dhanë për kombin dëshmohet nga dëshira e zjarrtë që ata kishin për të përhapur dijen në popull. Me ato mundësi që kishin, ata u bënë iniciatorët e krijimit të teksteve të para shkollore të dokumentuara. Ata i përkushtuan një rëndësi të madhe pajisjes me mjetet e duhura të mësimdhënieës, për të bërë më tej dhe shpërndarjen e tyre të nxënësit. Të edukuar dhe me frymën e lartë të patriotizmit, këta nxënës do të bëheshin në të ardhmen dhe pasuesit e ideologjisë së mësuesve të tyre dhe luftëtarë të devotshëm për luftën për liri dhe pavarësi.

Në shenjë nderimi, respekti dhe kujtimi për kontributin e Mësonjëtores së Korçës dhe mësuesve të saj, 7 Marsi është caktuar si Ditë e Mësuesit dhe e shkollës shqipe. Ndërtesa ku u hap kjo shkollë sot është muzeum kombëtar i arsimit.

## 80-VJETORI

# Brigada e VII-të Sulmuese, 120 beteja dhe 3200 kilometra marshime

• *Brigada e VII-të Sulmuese ishte një nga brigadat më të shquara të Frontit Nacionalçlirimtar gjatë fundit të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Komandanti ushtarak ishte Gjin Marku dhe komisar politik Kadri Hoxha*

**M**e urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, më 17 mars 1944, në Vlush të Skraparit u formua Brigada e VII Sulmuese (Br.VII S). Në rreshtat e brigadës u rreshtuan partizanë me eksperiencë në luftë të batalioneve të qarkut të Beratit, të Grupit të Skraparit, të batalionit të rinisë "Margarita Tutulani" etj. Erdhën gjithashtu dhe mjaft partizanë nga qarku i Gjirokastrës dhe nga qarku i Korçës. Në komandë të brigadës u emëruan: komandant Gjin Marku dhe pas Musa Daci; komisar Kadri Hoxha dhe më vonë oficer karriere, Qazim Kapisyzi. Kuadro dhe luftëtarë ishin dhe Adil Çarçani, zëvendës-komisar, Ramiz Alia përgjegjës i rinisë i brigadës, etj. Situata në të cilën u krijua Br. VII S ishte shumë më e favorshme nga ato në të cilat u krijuan Br. V-VI S.

80 vjetori i krijimit të Brigadës së VII-të na kujton disa nga kuadrot që përmendëm më lart, të cilët përbëjnë bërthamën e kuadrove politikë si Adil Çarçani, Myqerem Fuga, Niazi Demi, Tajar Grepcka, Ramiz Alia, Nexhmedin Ballka etj. Më vonë dolën kuadro drejtuese të kompanive të kësaj Brigade, komunistë që ashtu si e nënvizion Myqerem Fuga, u bënë promotori i celulave të kompanive dhe dhanë një kontribut të madh në forcën goditëse të Brigadës, si Foto Çami, Koli Myzeqari, (dëshmor), Skënder Libohova (dëshmor), Guçe Stropani etj.

## ROLI I GJIN MARKUT

Me të marrë urdhërin, Gjin Marku iu vu punës organizuese të kësaj Brigade. Në shtëpinë e Kahreman Yllit, në prani të Myqerem Fugës u bë organizimi i Brigadës ashtu si është dhënë në historik. Batalioni i Parë u formua kryesisht me partizanë të Qarkut të Beratit me një kompani nga Devolli; Batalioni i Dytë kryesisht me partizanë të grupit të Skraparit, ndërsa Batalioni i Tretë u formua nga partizanë të Qarkut të Gjirokastrës, me në krye Gani Nivicën (dëshmor), me një kompani nga Batalioni i Dëshnicës.

Ceremonia u zhvillua më 17 mars 1944 në fshatin Vlushë të Skraparit, në atë fshat, ku dy muaj më parë nazistët gjermanë vranë 114 skraparllinj, duke përfshirë edhe ata të fshatrave Krushovë, Kapinovë e Turbehovë.

I njëqindpesëmbëdhjeti, Veseli, rrojti, jetoj, për t'u treguar ditëve të pasçlirimtimit tmerret e luftës dhe vuajtjet e atij populli liridashës.

"Vlusha vlon", "Stalini sulmon". Këto ishin parrulla e kundërparrulla të natës së parë, drejt aksionit, drejt



jt Beratit. Në garnizonin e Beratit e kryesisht në Kuçovë kishte pak gjermanë, kryesisht kishte forca të Ballit Kombëtar dhe të Gjindarmërisë. Mbrojtja ishte organizuar kryesisht me pikëmbështetje të forta. Mund të përmendim Kalanë, Shëndëllinë, Lysin e Beçit dhe vetë kazermat ushtarake.

Kuçova, vetë fusha e Otlakut dhe Ura Vajguore kishin të tjerë garnizone mbrojtje. Këto objekte, të lidhura me copa transhe dhe hendeklidhje përbënin një mbrojtje të fuqishme, me të cilat do të përballlej Brigada e VII-të. Sekretin e armikut qëndronte në shumëllojshmërinë e pozicioneve të zjarrit. Disa nga këto ishin të pushtuara dhe disa jo. Tanket nuk qëndronin në qytet. Ato afroreshin pranë kazermave vetëm kur partizanët e Brigadës së VII-të e rrezikonin qytetin.

Pas urdhërit të Komandantit vinin urdhëra të tjerë, të nënshkruara nga Spiro Moisiu për çlirimin e Beratit, për përbalimin e Operacionit të qershorit, për çlirimin e Kuçovës etj. Për çlirimin e Beratit dhanë ndihmesën e tyre vetë beratasit. Qysh në goditjen e parë mbi harkun e parë mbrojtës ra partizani Thoma Shqina, një nga të rinjtë e zjarrtë të këtij qyteti. Po atë ditë ra Rahmi Stropani nga treva atdhetare e Devollit. Nuk mund të numërohen aktet heroike të partizanëve nga Zona e Skraparit dhe e Dëshnicës.

Në faqet e historisë së Brigadës së VII-të Sulmuese radhiten shumë partizanë e kuadro që ranë në ballë të luftës. Po përmendim disa nga kuadrot drejtuese politikë: Koli Myzeqarin, Skënder Libohova, ko-

mandant batalioni, Haxhi Dokon, Fahri Zaimin, Mehdi Vilën, Loni Odriçanin, Thimi Tanin, Naim Gurin, komisar kompanie.

## LUFTIMET E BRIGADËS

Brigada luftonte dhe rritej në numër. Gjatë rrugës luftarake u shtua dhe me dy batalione të tjerë. Forcat pushtuese nuk u ndjenë mirë dhe komandanti i Xhandarmërisë Mbretërore me informacionin nr.94/6, datë 18.3.1944 i drejtohej Ministrisë së Punëve të Brendshme:

"Në rajon gjendja paraqitet kritike. Çetat komuniste të Skraparit kanë mobilizuar krejt banorët e atij rrethi dhe kanë formuar Brigadën e shtatë komuniste. Kështu që fuqia e tyre arin dei në 1000 veta." Në të vërtetë edhe pse brigada la në fushën e betejës 302 dëshmorë, arriti numrin në 2229 partizanë. Ata 142 partizanë që u plagosën, u

mjekuan nëpër spitalet partizane dhe u kthyen sërish në luftë, të cilën e vazhduan deri në Vishegrad. Kur i hedh një sy korrespondencës me të cilën funksiononte brigada, çuditësh. Si nuk janë rrezikuar ata korrierë, që kalonin nëpër plumba? Ato janë shkruar rrëzë shkurreve e ulur nëpër gurë, se ato ishin tryezat e luftëtarëve. Një letër është shkruar në fshatin Duhanas të Beratit, një tjetër në Karkanjoz në mes të dimrit. Dallohen ende pikat e shiut që kanë rënë mbi to.

"Deri sot në Tomorr ndodhen edhe skuadra të brigadës VII. Armiku ndodhet i përqendruar në Qahajas, Vodice, por i mbërthyer në vend dhe pa iniciativë. Sasia e tyre mbërrin deri

300 veta mercenarë të veshur dhe ballistë të vendit. Më datën 6, pjesa e Brigadës VII largohet prej këtej në drejtim të Skraparit dhe këtu mbeten forca të vendit, të cilat do të patrullojnë. Në mbrëmjen e datës 5 ndonjë kompani të mbërrinë në Tomorr ku do të marrë ndërlihdje. Skuadrat le të ulen në Perisnakë për të qenë si presion për armikun. Në datën 6 do të jemi edhe ne në Tomorr për t'u takuar me ju, pra ju presim...Te fala shoqërore Komandanti Shtabit, Mestan Ujaniku, zëvendëskomisari, Kahreman Ylli."

Lëvizja Nacionalçlirimtare nuk ishte thjeshtë luftë, por një shkollë nga ku mësuam 312 partizanë anal-fabetë. Që nga lufta dolën kuadrot që drejtuan ekonominë në fillimet e rindërtimit të vendit.

Këtu i bënë akademitë dhe universitetet Adil Prishtë, Qerim Gjineci, Neshat Hysi, Orhan Frashëri, Ramiz Alia, Kadri Hoxha, Gjin Marku Bilo Bregu, Myqerem Fuga, Adil Çarçani, Myzafer Trebeshina, Izet Hysi, Qazim Kapisyzi, Musa Hysi, Sulo Gradeci, Vala Frashëri, Foto Çami, Njazi Braçe...

Gratë ishin një forcë tjetër që barazoheshin me burrat në luftë, edhe pse ballistët i këshillonin që të merrnin me vete edhe maternitetet. Ato ishin radhitur krahu vëllezërve të tyre, që të shporrnin pushtuesit dhe mbështetësit e tyre.

Veprimtaria e Brigadës së 7-të Sulmuese nuk mund të përmbledhet në një shkrim përkujtimor, por u përpoqëm të japim detaje nga ato luftime e beteja që nuk kanë të numëruar, por deri tani janë publikuar 120 beteja dhe 3200 kilometra marshime.

## AKTUALITET

# SIGURIA KOMBËTARE, MINISTRI PELESHI KONSULTIM ME USHTARAKË TË LARTË DHE EKSPERTË TË FUSHËS

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi diskutoi në një takim konsultativ për çështje të sigurisë kombëtare me grupe interesi: ushtarakë me grada madhore, drejtues të shoqatave të ushtarakëve në reserve e të OBVL, përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ekspertë të fushës së Sigurisë dhe Strategjisë nga Akademia e FA dhe nga Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë.

Në fokus të diskutimeve ishte rishikimi i dokumenteve strategjike të Sigurisë dhe Mbrojtjes, përgatitja e kapaciteteve përballë sfidave të kohës, në përputhje edhe me kërkesat e Aleancës së NATO.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi evidentoi disa faktorë që kanë shtuar nevojën për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, duke nisur nga kërcënimi që agresioni rus në Ukrainë paraqet për zonën euroatlantike, terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, konfliktet hibride dhe sulmet kibernetike, etj.

Gjithashtu ministri Peleshi u shpreh se gjatë vitit 2024 Buxheti i Mbrojtjes është në nivelin 2% të PBB, sipas kërkesave të NATO; e krahasuar me vitin 2023 është rritur rreth 22%. Si arritje të vitit të kaluar ministri i Mbrojtjes përmendi zhvillimin e kapaciteteve të Mbrojtjes Kibernetike, kompletimin me dy helikopterë e parë Black Hawk, rritjen e kapaciteteve operacionale të FA-së, ngritjen e Qendrës së Inovacionit, shërbimin satelitor për institucionet ligjzbatuese dhe zhvillimit apo investimet në Edukimin Profesional Ushtarak sipas modelit Eest Point.

Fokusi në vitin 2024, sipas ministrit Peleshi do të jetë në ngritjen e



kapaciteteve të Mbrojtjes Kundërajrore me bazë në tokë dhe kapaciteteve operacionale të sistemeve stacionare dhe të lëvizshme për zbulimin dhe neutralizimin e objekteve fluturues pa pilot (C-UAS), ndërsa informoi se së shpejti do të fillojë flota e dronëve "Bayraktar". Konsolidimi i flotës së helikopterëve

Black Haëk, avancimi inovativ dhe teknologjik, modernizimi i vazhdueshëm i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore dhe Detare të RSH, apo forcimi i sistemit të përgatitjes dhe Mbrojtjes Civile janë disa nga sfidat e tjera për vitin 2024. Një vëmendje e veçantë do të jetë gjatë këtij viti opera-

cionalizimi i Bazës Ajrore të Kuçovës, fillimi i zhvillimit të projektit ushtarak të Porto Romano, modernizimi i zonës trajnuese në Bizë, apo edhe stërvitja dhe ndërveprueshmëria, kryesisht nëpërmjet stërvitjeve ushtarake, si "Defender Europe".

Shqipëria, tha gjatë fjalës së tij ministri Peleshi, do të qëndrojë e angazhuar në misione, operacione dhe iniciativa të NATO, BE, OKB dhe koalicionet vullneti, në 8 misione ndërkombëtare, ku janë angazhuar 172 personel ushtarakë. Ndërsa vitin tjetër Shqipëria do të shtojë praninë e saj në KFOR, Bosnje - Hercegovinë dhe po vlerësohen angazhime të tjera shtesë në NATO dhe BE.

Sipas ministrit të Mbrojtjes ky vit është i rëndësishëm pasi shënon edhe 15 - Vjetorin e Anëtarësim-it të Shqipërisë në NATO si dhe 80 - Vjetorin e Çlirimit të vendit.

"Kërcënimet e reja dhe në zhvillim në mjedisin e ri të sigurisë kërkojnë prej të gjithëve ne të dëgjojmë fort thirrjen e jashtëzakonshme të kombit. Le të shërbejë ky takim për të ndërtuar mirëkuptim publik, partneritet dhe bashkëpunim për të gjeneruar diskutime mbi politikën tonë të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, dhe të punojmë për një të ardhme nga ku brezat do të shohin pas me krenari.

Siguria dhe qëndrueshmërinë jonë kombëtare, është e lidhur me mënyrën se si ne e përcaktojmë pjesëmarrjen dhe kontributin tonë", - u shpreh ministri Peleshi, në këtë takim konsultativ.

Ndërkaq, sipas ministrit do të vijojë përmirësimi i trajtimit të ushtarakëve aktivë, pas rritjes së pagës me afro 40% në vitet e fundit.

## GJENERAL NEXHIP VINÇANI DHE BRIGADA QË S'U BË "HERO I POPULLIT"

(Vijon nga faqja 2)

doli "tradhtar e armik i partisë e i popullit"... s'kishte shans që të bëhej Brigada e 4. S, "Hero i Popullit" (!).

x x x

**Gjithëkush mund të pyes: A është Nexhip Vinçani njeriu "HERO" që dha gjithçka për Epopenë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Qarkun e Korçës dhe më gjerë? A do të ishte busti i Nexhip Vinçanit, figura më e përshtatshme për të simbolizuar sakrificat e korçarëve për periudhën e LANC në Qarkun e Korçës? A do ta nderonte Korçën një përmendore e tillë e Nexhip Vinçanit, si figurë që e nxorën situatat dhe sakrificat e jashtëzakonshme që u desh të kaloheshin me sukses në këtë Epope të Lavdishme?**

**Atëhere: "Çfarë nuk ka bërë tjetër Nexhip Vinçani për ta merituar atë përmendore? E nëse dikush do të thoshte se mund të jepte edhe jetën, përgjigja do të ishte se ai u varros me plumbin në trup, kur u plagos në luftë për çlirimin e Pogradecit. Korça nuk ka një simbol të përmasave të tilla, për periudhën e Epopesë së Luftës ANCL, ashtu siç ka Themistokli Gërmenjin për periudhën e vet. E, pra, të nderuar miq: Vlerësimi për gjeneral Nexhip Vinçanin, (përveçse për gjithë vendin), është së pari vlerësim për Korçën, për institucionin e Bashkisë dhe Këshillin bashkiak të qytetit të Korçës.**

Shënim: (Duke qënë në përfundim të librit "GJENERAL NEXHIP VINÇANI NDERI I KOMBIT" që koinci-

don me 80-vjetorin e krijimit të Brig.IV-S, nuk mund të mos shkruaja për "Telegraf" (gazeta që mban një qëndrim të prerë në mbrojtje të vlerave të LANC) një "Kujtesë-Homazh" për jetën e gjeneralit, përplasjet reale me regjimin e Hoxhës, ndonjë konkluzion e të pathëna deri më sot ...Me këtë rast, u shpreh mirënjohjen vajzave të heroit të cilat kanë publikuar gjithçka për personalitetin e babait të tyre, shkrimtarin e publicistin e shquar z. Shpendi Topollaj, i cili ka hartuar parathënie unike për librin, pa harruar konsulencën me Dr. Genc Danin, dhëndërrin e Nexhipit, i cili ruan një arkiv të vyer kujtimesh për N.Vinçanin).

### SHKRIMJETA E GJENERAL NEXHIP VINÇANIT

- Lindi më 21 gusht 1916
- Kreu gjimnazin në: Korçë, Tiranë e Shkodër
- Jurisprudencë, studime në Romë, Itali
- 1941, pranverë, arrestohet, si organizator i demonstratës antifashiste të studentëve shqiptarë.
- 1941, 28/11/ kthehet në atdhe.Radhitet në LANC.
- 1942, 16 shtator, delegat në Konferencën e Pezës, përfaqësues i Rinisë Antifashiste,
- 1942-43 organizator i çetave e batalioneve partizane, Korçë
- 1943, mars, Komand. Operac. për çlirimin e Leskovikut.
- 1943, qershor, kom. shtabit për çlirimin e Korçës
- 1943, korrik, Kom. Shtab, Oper. për çlirimin e Përmetit
- 1943, 28 nëntor, plagoset në luftë për çlirimin e

### Pogradecit

- 1943, 28 dhjetor, Komandant i Brig. IV-S
- 1944, tetot-17 nëntor, zv/komandant i Shtabit Operativ për çlirimin e Tiranës.
- Komandant i divizionit Korçë.
- Drejtor i Drejtorisë Operative
- Komandant i Divizionit në Gjirokastrë.
- Kongresi i Parë i pksh e zgjedhi kandidat të kqj
- 1945-48. Akademia Usht. "Voroshilov" në Moskë.
- 1948, divizionet Peshkopi e Diviz. Korçës
- 1949 drejtor, Drejtoria Operative e Min. Mbrojtjes Zv/Shefi i Shtatmadhorisë së Ushtrisë.
- 1949. Në provokacionet e gushtit, kryeson i grupin operativ.
- 1949 Kongresi 1 pksh. i jep goditje të cfrenuar Nexhipit
- 1950-Shkarkohet nga posti i Zv / Shefit të Shtatmadhorisë dhe i kandidatit të Kom. Qendror.
- 1950, shkurt, plenumi kqj -E. Hoxha e godet personalitetin e N.Vinçanit
- 1951 emërohet shefi i Degës ushtarake në Elbasan. Komandant i Divizionit të Parë në Tiranë.
- 1953 Komandant i Mbrojtjes Bregdetare.
- 1956 e lirojnë nga detyra dhe nga ushtria.
- 1956 në Konf. e Tiranës E.H. i jep goditjen fatale.
- 40 vjeç, dërgohet punëtor i thjeshtë në Lushnjë e përgjegjës i kantierit në Fier.
- 1958 arrestimi i parë i Nexhipit
- 1971 del në pension pleqërie

## OPINION

*Pavarësisë së Kosovës i kanë paraprirë shumë sakrifica dhe vështërsi të papërshkrueshme që të jetohet në liri*

# KOSOVA 16 VITE PAS SHPALLJES SË PAVARËSISË



**Nga Bashkim Hisari**

Duke iu përgjigjur thirrjes së popullit për liri e paqe dhe për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor, afirmojmë krenarinë dhe synimet e qytetarëve për të përballuar trashëgiminë e dhimbshme të së kaluarës, më 17 shkurt 2008, deputetët në Kuvendin e Kosovës, shpallën Kosovën Republikë demokratike, laike dhe multietnike, në parimet me standardet më të larta evropiane për të drejtat e njerut dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjeve.

Prej 16 vitesh, Kosova është shtet i pavarur dhe pasqyron vullnetin e popullit të saj, dëshirën e shqiptarëve për t'u integruar plotësisht në familjen euroatlantike. Pavarësisë së Kosovës i kanë paraprirë shumë sakrifica dhe vështërsi të papërshkrueshme që të jetohet në liri në shtetin e pavarur. Populli i Kosovës kujton rreth 55 mijë luftëtarë dhe 6200 dëshmorë që e dhanë jetën në luftë kundër nazi-fashizmit. Kujton Konferencën e Bujanit ku u vendosën themelet e shtetësisë së Kosovës. Kujton edhe krimet gjatë luftës së fundit në Kosovë, kur forcat serbe vranë 12 843 shqiptarë, prej tyre 1 741 femra dhe 1 396 fëmijë nën moshën 18-vjeçare dhe luftën e UÇK-së që me ndihmën e aleatëve ndërkombëtarë e çuanë më tej vullnetin e popullit për liri, vetëvendosje dhe pavarësi.

Gjatë këtyre 16 viteve në liri ka pasur përparime të mëdha. Në Kosovë mbrohet pavarësia, kushtetutshmëria, ligjshmëria, paqja e siguria. Po bëhen ndryshime të mëdha demokratike, politike e shoqërore. Po zbatohen reformat në ekonomi dhe drejtësi. Po investohet dhe po shënohen rritje në ekonomi. Të drejtat dhe liritë e komuniteteve respektohen në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare. Kosova tani ka institucionet e saja, Forcat e sigurisë, policinë, doganën, prokurorinë, gjykatat, ligjet... Mëse 100 shtete e kanë njohur pavarësinë e saj. Popullit po i ofrohet një perspektivë e qartë për të ardhmen e tij evropiane, për antarsim të plotë në Bashkësinë Euro-atlantike.

Me Marrëveshjen e Ohrit të vitit 2023, Serbia u pajtua të vendosë marrëdhënie të mira fqinjësore me Kosovën në bazë të të drejtave të barabarta bazuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, t'i njëhë dokumentet, simbolet kombëtare, të zgjidhë mosmarrëveshjet me mjete paqësore, duke u përmbajtur nga

kërcënimet dhe përdorimi i forces, të mos kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në organizatatë ndërkombëtare, mos të bllokujë përparimin e Kosovës në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian dhe të vazhdojë procesin e dialogut me Prishtinën që duhet të rezultoj me një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve të ndërsjella.

Mirëpo, regjimi i Beogradit nuk po zbaton pikat e Marrëveshjes së Ohrit e as Marrëveshjet tjera që u arritën në kuadër të dialogut me Kosovën, lehtësuar nga BE dhe SHBA.

Ndonëse shtetësia e Kosovës është e pandryshueshme dhe e padiskutueshme, krerët e regjimit serb, edhe 16 vjet pas shpalljes së pavarësisë, nuk e pranojnë ekzistencën e Kosovës si shtet sovran. Me forma të ndryshme dramatike, vazhdojnë fushatën agresive duke aluduar edhe përdorimin e forces kundër shqiptarëve dhe Kosovës. Me incidente po krijojnë tensione serioze dhe po rrezikojnë sigurinë në rajon. Kjo u dëshmuar edhe me aktin e agresionit të Serbisë ndaj Kosovës në Banjskë më 24 shtator 2023, kur grupi terrorist paramilitar i pajisur e i trajnuar në Serbi tentoi të okupojë veriun e Kosovës.

Presidenti serb Aleksandar Vuçiq, me gënjeshtria fajson dhe kërcnon shqiptarët se po kryejnë veprime

• Populli i Kosovës kujton rreth 55 mijë luftëtarë dhe 6200 dëshmorë që e dhanë jetën në luftë kundër nazi-fashizmit. Kujton Konferencën e Bujanit ku u vendosën themelet e shtetësisë së Kosovës. Kujton edhe krimet gjatë luftës së fundit në Kosovë, kur forcat serbe vranë 12 843 shqiptarë, prej tyre 1 741 femra dhe 1 396 fëmijë nën moshën 18-vjeçare dhe luftën e UÇK-së që me ndihmën e aleatëve ndërkombëtarë e çuanë më tej vullnetin e popullit për liri, vetëvendosje dhe pavarësi

që përbëjnë "spastrim etnik". Ai dhe pushteti i tij antidemokratik, po përdorin çdo mundësi që kanë, për të krijuar tensione dhe për ta bllokuar dialogun. Në praktikë të festimit të 16 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe në kohën kur serbët shfaqnin pakënaqësi lidhur me vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës për ta bërë euron si valutën e vetme për kryerje të pagesave, në katër qytete në veri të Kosovës përkatësisht në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, të banuar me shumicë serbe, janë parë disa grafitë të reja me mesazhet "Kur të kthehet ushtria në Kosovë", Brigada e Veriut jeton", "Mos u shqetësoni, ne jemi këtu, po presim", "Kosova është Serbi", "Që nga 21.11. është detyrë e të gjithëve të rezistojnë në çdo hap" etj.

Besohet se autorët e këtyre grafitëve që po përhapin urretje, kërcenojnë dhe krijojnë tensione, janë pjesëtarët e dy organizatave si "Brigada e Veriut" dhe "Mbrojtja Civile" që veprojnë në veri të Kosovës dhe numërojnë qindra anëtarë nga radhët e komunitetit serb. Qeveria e Kosovës, këto dy organizata i ka shpallur si organizata terroriste.

Ditë më pare, nëpër hyrje të ndërtesave dhe rrugëve të ndryshme në veri të Kosovës, u shpërndanë fletushka që udhëzojnë serbët si t'iu kundërvihen Policisë së Kosovës dhe administratës komunale: "t'i gjuajnë me gjësende përfshirë edhe me kokteje molotovi, shërbyesit komunal të goditen me grusht" shkruan në këto fletushka që mbajnë mbishkrimin e organizatës "Mbrojtja popullore".

Të gjitha këto dëshmojnë se regjimi i Beogradit po jeton jasht realitetit në Kosovë. Ka mospajtime me shumicën e shteteve të rajonit, Me manipulime dhe premtime të rrejshme ndaj një pjese të mirë të qytetarëve dhe me mbështetjen e mashtruesëve, hajdutëve, kriminelëve, grabitçarëve dhe hegjemonistvë për Serbinë e Madhe, vazhdon të mbijetoj.



## PROFILE

# “500 vjet kraljat kanë thanë, ruaju fort ku të ketë shaljanë!

Nga Gjin Musa

## HISTORIA E SHALËS: POZITA E TERRITORIT TË FISIT

Rajoni i fisit të Shalës ndodhet në trevën e Dukagjinit, në veri të lumit Drin, në qarkun e tanishëm të Shkodrës, në Shqipërinë e veriut. Shala jeton në pjesën e sipërme të luginës së lumit Shalë, afer fshatit turistik Theth, ku përfundon lujina, që rrethohet me malet e larta nga të gjitha anët. Shala kufizohet, sipas rajonit tradicional të fisit, në perëndim me Bogën, Shkrelin dhe Planin përtej maleve, në veri me Kelmendin matanë maleve, në lindje me Krasniqin dhe Nikajin përtej maleve dhe në jug me Shoshin. Ngulimet kryesore të Shalës janë: Abati, Bregluma, Gimaj, Lekaj, Lotaj, Ndërlysa, Nënnavriqi, Nicaj, Pecaj, Thethi dhe Vuksanaj.

## POPULLATA

Emri Shala paraqitet në gjuhën italiane në raportin kishtar të Bonaventura di Palakolo nga Verçelli në Pied-mont, më 1634. Ai e quante këtë rajon Sciala. Në raportin e tij kishtar, të vitit 1671, vizitori papnor në Shqipëri, Pjetron Stefano Gasparini, e përdori fjalën Sala dhe shënoi:

“Në këtë anë të malit Agri, në fund të Pulatit të sipërm gjendet fshati i Shalës, që përbëhet nga 32 shtëpi dhe 20 frymë. Ata janë të fortë dhe të armatosur, si me kushtet fizike tradite ashtu edhe me pozitën e tyre janë tërësisht të pavarur. Ata i sulmojnë pareshtur rajonet fqinje turke dhe pothuajse, gjithmonë kthehen si ngadhënjës.

Në hartën e vitit 1688, të hartografit venedikas, Francesko Maria Koronelli, ky truall quhet Scialia. Ai, në hartën e vitit 1821, të diplomatit francez Ygë Pukvill, paraqitet edhe si Scialia. Thuhet se ky term ka të bëjë me fjalën shqipe shalë, shalësinë, që do të thotë “tokë jopjellore dhe e thatë”. Por ky shpjegim nuk është aq bindës nga pikëpamja etimologjike, sepse Shala është një ndër vendet e pakta në malet e veriut që është e pjellore dhe nuk është e thatë.

Shala është një fis që përbëhet nga një bashkësi që është e vetëdijshme për lidhjet e përbashkëta të gjakut, të historisë dhe të stërgjyshit.

Shala ka lidhje të ngushta me fisin e Shoshit. Te dy fiset janë kryesisht katolike dhe nuk kanë lejuar që të vendoset asnjë mysliman në luginë. Mbrojtësi i shenjtë i Shalës është Shën Gjoni, Evangjelisti, festa e të cilit kremtohet më 27 dhjetor. Megjithatë, siç ishte edhe rasti me fisin Nikaj, shumë pjesëtarë të fisit u kanë dhënë fëmijëve emra myslimanë. Familia katolike e Shalës është themeluar më 1763, ndonëse disa herë është braktisur gjatë historisë. Fisi Theth është bërë famulli e pavarur më 1892.2

Shala e kremton edhe festën e Shën Mikelit, më

29 shtator, me prerjen dhe pjekjen e një dashi në hell. Para darkës, në vigjilje të festës së Shën Mikelit, në meshë ndizet një kandil dhe pas lutjeve shtrohet darka për nder të të shenjtit. Dikush nga familja duhet të bëjë roje tërë natën deri të nesërmen, për të siguruar që kandili të mos shuhet.

Nëse shuhet kandili, atëherë fati i lig do ta njollosë tërë familjen. Në: “Informata të shkurtra për fiset e Shqipërisë së veriut, veçanërisht të Malësisë së pavarur”, të botuar më 1841, Nikollai, Princi i Vasojeviqëve, pohon se Shala ka një popullatë prej 4000 banorësh, prej të cilëve 1000 janë burra të armatosur.3 Hajsint Hekardi, në gjysmën e parë të shekullit nëntëmbëdhjetë, raportonte se Shala kishte 275 shtëpi dhe 2500 banorë. Në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, thuhet se kjo trevë kishte 3000 banorë.

Inxhinieri austriak, Karl Shtainmetc, i cili në gushtin e vitit 1903, i ka bërë vizitë rajonit të Shalës, ka lënë këtë vërejtje:

“Shala është fisi më i fortë dhe më i njohur në Malësinë katolike. Përbëhet nga 500 shtëpi dhe afro 4500 frymë.

Anëtarët e këtij fisi u përmbahen me një saktësi të madhe gjakderdhjes dhe tokave të yjetra. Dëshmia më e mirë për këtë janë ndërtesat e shembura të cilat i pashë derisa po kaloja rrugën nëpër këtë territor. Ky fis i ka lidhjet e ngushta me fisin e Shoshit, i cili jeton në pjesën jugore të luginës. Në tërë këtë luginë ka tre misionarë: njëri është në Abat, tjetri në Shosh dhe i fundit, që nga viti i kaluar, në Theth. Bajraktari i Shalës jeton në Pecaj, në truallin e Abatit.”4

Tani në Kosovë, pjesëtarët e fisit të Shalës janë të përqendruar kryesisht në rrethinat e Mitrovicës dhe të Trepçës, në rajonin kodrinor që i thonë Shala e Bajgorës. Bajgora është ngulimi më i madh i tyre, meqë ka 37 vendbanime. Ata ndahen në 4 klane ose vllazni: Gima, Peci, Maleti (ka farefisni me fisin Lotaj në Shqipëri) dhe Lopçi. Po kështu ka një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të fisit të Shalës në Isniq, te Lluka e Epërme dhe në Strellcin e Ulët afër Deçanit, në Ujëmirë në lindje të Klinës, në Kopiliqin e Epërm në Drenicë, në Rakosh dhe Çitak në Podgor dhe në disa fshatra të tjerë të luginës së epërme të Lepencit. Ç është e vërteta, në numra më të vegjël, ata janë të pranishëm në mbarë Kosovën. Shumica e tyre e kanë ruajtur ndjenjën e përkatësisë fisnore, shkruan KultPlus.

## LEGJENDAT PËR FISIN, STËRGJYSHËRIT DHE HISTORIA

Stërgjyshi legjendar i fisit të Shalës quhej Zog Diti, i biri i Dit Murrin dhe nip Si u formua fisi Shale, edhe nga cili vend erdhen te paret tane ne Isniq ?

Simbas disa te dhenave, por keto fakte jan te thurura edhe ne kenge pergjigja eshte kjo -----”



shpresoj shum qe eshte pergjigje e sakte “

Siç e dim shumica se fiset Shala, Shoshi dhe Mirdita jan Vellezer te nje Gjaku ( bile ne Dukagjin te Shqiperis deri von ruanin traditen me fanatizem dhe kto tri Fise Legjendare nuk u martonin ndermjet vete). Fiset ne Fjale kishin Prejardhjen nga Pashtriku i Gjakoves , dhe kjo eshte mire e treguar edhe ne kenge, nga aty u shperngulen ne Periferi te Shkodres me saktësisht ne Shirokë ( nga ky vend eshte shkrimtari Filip Shiroka ) ...

Keta tre vellezer pasi u rriten dhe u shumuan , njeri nga keta u ndal ne Mirdit dhe dy shkuan ne Dukagjin te Shqiperis ( i cilli ndodhet n' mes dy malsive dmth Malsis se madhe dhe asaj te vogles apo siq njihet ne popull Malsia e Gjakoves) Thuhet Vellau qe krijoj " Mirditen muar Buken " , Vellau qe Krijoj Shalen e muar " Shalen pa kali " , Dhe Vellau qe Krijoj " Shoshin i ra hise Shosha bosh". Ne at kohe nuk egzistonte Dukagjini , Ishte Malsija e pa ndar, thuhet se kta dy vellezer deputuan ne Malsi me ndihmen e shpates qa na ep me kuptua qe me luft kunder Fiseve te Malsis i moren keto Troje,, dhe e ndan Malsin ne dysh, dhe kjo pjes sod e asaj dite quhet dhe njihet si Dukagjin, dhe Dukagjinasit e sotem si thon vetes Malsor por Dukagjinas dhe mburren me ket emer te madh. Nder personat me me influenc ne Dukagjin ( Shal e Shosh ) ishin : Lek Dukagjini i cilli eshte edhe Protagonisti kryesor i Kanunit,

Pastaj vin Mark Lula i Shales Mehmet Shpendi me Djelmnin e Shales, Kol Mark Kola, Mark Sadiku pleqnar i njohur nder Veriun Marash Pali e shum te tjere. Keta burra Shaljan ishin te vetmit qe sju nenshtruan perandoris Osmane dhe me vone asaj Serbo-Malazeze, nder kujtumet me me vler qe kan bere buje ne at kohe nga Shaljanet jane : Shtat Shaljanet kur ikan vra Vezirit Djalin , Vrasja e Ali pashes se Begollit nga Kol Mar Kola, Vrasja qe Beri Qerim Delia ne Shkoder e shum e shum ngjarje te medha historike. Ne lidhjen e Prizerenit ishte po ashtu pjesmarres Kol Mar kola dhe Mark Lula i Shales. Jan disa thenje per Shalen qe edhe sot e kesaj dite thuhet : " Mark Milani gjakpirsi i Shqiptarve ka than : Shala nuk dorzon kokat pa arme, por as armet pa len Kokat", "500 vjet Krajlrat Kan than Ruju fort kut ket Shaljan" , " Emrin Shals ne der T'Stamolls ja shkrov dhetsnja E Kol Mar Kols" etj,, Thuhet nga te paret tane qe ne ( Isniqi ) kemi rrenjet ne Gimaj te Shales nga aty u shperngulem dhe u Vendosem ne Isniq ( para se me ra ne Isniq thuhet nipi i jan Loti ishte halllig dhe e Martuan ne Velike sod Mal te Zi afer Qakorrit dhe edhe sod e asaj dite ata mbajm Mbiemrin Shaliç) e sa i perket Isniqit si u shumuam ne tre vllazni mendoj dhe jam i bindur qe Plqnaret e Isniqit te cillet kan kryer Shkoll dhe i kan ruajt me fanatizem keto ngjarje nje dit do naj tregojn...



## 95 - VJETORI I LINDJES


# JA PSE VETERANI I LANÇ GENC BALLANCA NDEROHET E RESPEKTOHET NGA TË GJITHË BASHKIM KADIU

- *Si kuadër me vizion perëndimor, përkrahu nga të parët lëvizjen demokratike, dhe së bashku me shokë të tjerë, si gjeneral Ernest Jakova, Zenel Bardhi, Idriz Hoxha, Eqerem Kuka, Osman Xhindoli etj. u bashkuan me organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ - OBVL dhe për një kohë të gjatë, kreu me sukses të plotë, detyrën e Kryetari të Degës për Durrësin*

Këtë 7 Mars Genc Ballanca feston 95-vjetorin e ditëlindjes. I lindur në 7 Mars të vitit 1929. Genci ishte djali i një familje të njohur për atdhetari me origjinë nga Dibra e Madhe. Babai i tij Xhevdet Ballanca, ka qenë oficer, që kishte studiuar në Akademitë Ushtarake të Romës e Stambollit, dhe gjithë aftësitë e tij i vuri në shërbim të popullit dhe Atdheut. Duke qenë antifashist, ai përkrahu dhe u lidh me figura të shquara të historisë tonë si Abaz Kupi, Nako Spiru, Iliaz Reka etj. Ai i priti me armë në dorë pushtuesi italianë më 7 Prill të vitit 1939 dhe vazhdoi luftën me forcat nacionaliste. Janë këto vlera, për të cilat ky atdhetar i shquar është dekoruar me rastin e 45 vjetorit të ndarjes nga jeta, nga Presidenti i Republikës, për veprimtari patriotike dhe është shpallur "Qytetar Nderi" i Durrësit me vendimin e datës 20.03.2011. Gjyshi i Gencit, Baftjari është ai që vrau një ditë pazari Mehmet Pashën. Nëna e tij vinte nga familja e njohur atdhetare e Dollive në Kavajë dhe me Xhevdetin patën tetë fëmijë të mrekullueshëm. I rritur në një mjedis të tillë, edhe Genci, sido që mjaft i ri dhe ende pa e përfunduar plotësisht shkollën e mesme,



por me ide të qarta për lirinë, u rreshtua me shokët partizanë; fillimisht në Grupin e II - të të Çetës së Pezës, ku më pas, falë guximit dhe trimërisë së treguar në luftime ju ngarkua detyra e Përgjegjësit të Rinisë të batalionit, dhe në vazhdim, porsa u formua Brigada e IV - të Sulmuese, ju besua detyra e zëvendës intendentit të saj. I mençur dhe me iniciativë, ai kudo që u caktua i kreu detyrat e ngarkuara me nder. U shqua në luftimet e zhvillu-



ara deri në largimin e plotë të armikut dhe pas çlirimit të vendit u emërua në Komandën e Përgjithshme, ku pa nga afër përpjekjet e pareshtura për rritjen, fuqizimin dhe modernizimin e ushtrisë tonë. Por në vitin 1948, duke parë nevojën që kishte për të familja e tij, ai vendos të kthehet në qytetin e Durrësit ku kryen detyra të ndryshme dhe të rëndësishme në ndërmarrje të sapokrijuara. Kudo që punoi u dallua për marrëdhënie korrekte me vartësit

dhe shokët, për përkushtim e thjeshtësi, gjë që edhe pasi doli në pension i dha të drejtën të nderohet e respektohet nga të gjithë. Këtë e tregojnë mesë miri edhe dekoratat e shumta që i janë akorduar ndër vite. Duke i mbetur besnik idealeve të pastra, duke mos u pajtuar për asnjë çast me krimet e kryera nga Partia - shtet dhe duke parë se në çfarë mjerimi e varfërie po e çonin Shqipërinë sloganet demagogjike, ai si kuadër me vizion perëndimor, përkrahu nga të parët lëvizjen demokratike, dhe së bashku me shokë të tjerë, si gjeneral Ernest Jakova, Zenel Bardhi, Idriz Hoxha, Eqerem Kuka, Osman Xhindoli etj. u bashkuan me organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ - OBVL dhe për një kohë të gjatë, kreu me sukses të plotë, detyrën e Kryetari të Degës për Durrësin, ku u tregua i pa lodhur dhe përherë i përkushtuar. Dega e OBVL - së në Durrës, nën drejtimin e tij u dallua për organizimin e shumë veprimtarive dhe shtimin e radhëve të saj. Edhe tani në moshë të shtyrë, Genc Ballanca vazhdon të interesohet pareshtur për mbarëvajtjen e shoqatës. Kryesia e OBVL i uron atij jetë të gjatë dhe të lumtur me familjen e tij të shtrenjtë.

## KRISMAT E MALIHERIT



Shuko Ramo Karaboli

### Neki ÇAKO

Shuko Ramo Karaboli lindi më, 15 Maj 1911 në fshatin Kallarati të Vlorës. Lajmi do të bëhej i ditur me anë të një maliheri që, për krenarinë e labit kur vinte në jetë një djalë do të shtihet në pushkë. Maliheri asnjëherë nuk është lëshuar nga dora e labit dhe gjithë shqiptarëve. Gryka e tij vetëtin dhe asnjëherë nuk e zë ndryshku. Si një ogur i mirë një vit më vonë i njëjti maliher do të jepte lajmin se Ismail Qemali kishte shpallur mëvetësinë e Shqipërisë në Vlorë. Në vitin 1913-1914 pushtimi grek e bëri Kallaratin të bashkohet në një të vetëm për tu mbrojtur nga andartët e pa shpirt. Numuri i tyre ishte i lartë dhe nuk ishte në propocion me banorët. Si një thirrje për bashkim doli edhe kënga: "Kallarati 100 shtëpi/ O sot.../ O, kurrë... më njeri!"

Do të vinte viti 1918 kur Shukua i vogël djali i Ramo Karabolit do të filloje në shkollë të mësonte shkrim e këndim. Ai shquhej për një shkrim të bukur dhe ishte i saktë në përgjigje. Pas përfundimit të shkollës fillore atij

i duhej të vinte në ndihmë të familjes që në moshë fare të vogël. Varfëria kishte pllakosur ngado! Duhej të ndihmonte në bujqësi dhe me ato pak bagëti që kishin të siguronin produktet bazë të ushqimit. Gjatë ditës me bagëti ai i binte fyellit dhe shquhej për një zë të kthjellët kur këndonte. Jeta ecte me peripecitë e saj ndërsa, Shukua po rritej. Së bashku me të po hidhte shtat edhe Xhevo Osmënaj të cilës ja kishte vënë syrin dhe donte ta kishte të vetën. Dhe ashtu u bë. Ata u martuan bashkë dhe lindën dy vajza dhe një djalë. Hurmanë, Pashakon dhe Saminë. Jeta ecte dhe Samiu djali i vetëm i Shukos do të hidhte shtat .Trupi i tij i bukur dhe flokët e verdhë ja shtonin edhe më shumë krenarinë Shukos. I gëzohej faktit se djali po rritej e do ta kishte krah. Flokët e verdhë janë karakteristikë për Kallaratasit. Ka edhe një këngë trimash për ta, e cila i personifikon edhe për ngjyrën e flokëve: "Sinan Malo çepe verdhë/ E punonte mire dyfeknë".

Shuko Karaboli nuk e hoqi dyfekun nga supi. Pas vdekjes së të atit, atij i ngeli barra e rëndë, por nuk u përkul kurrë. U nis në Vlorë në vitin 1939 në luftë kundër breshkaxhinjeve italianë. Luftimet ishin të përgjakshme, trimëri të pa shëmbullta. Ai së bashku me fshatarët e tjerë u kthyen të dëshpëruar, pranë familjeve. Barra ishte e rëndë. Familjes duhej t'i sigurohej ushqimi. Ndaj vendosi t'i kthehet blektorisë dhe ngriti stanin e tij në vitin 1942 në pllajtat e bukura të vargmalit të Pogonicës. Aty nisi dhe veprimtaria e Shukos. Ai do të priste e përcillte shumë luftëtarë, që ishin hedhur në aksion për shfarosjen e okupatorit. Shukua i priste në stan, i ushqente dhe u krijonte kushte të shploheshin dhe mundohesh t'ju jepte informata për vëndodhjen dhe numurin e pushtuesve. Ai u siguronte armatim dhe municione, por kjo nuk i mjaftonte ndaj u hodh edhe vetë në aktivitet. Kështu në vitin 1942-1943 u bashkua

në luftën e Gjormit, kundër italianëve. Ai u bë pjestar i çetës së Kallararit. Në mars të vitit 1944 u bashkua me fshatarët e vetë në brigadën e VI "sulmuese" ku bënte pjesë edhe vëllai i tij, Shuko Karaboli si luftëtar i kësaj brigade. Përlëshjet me nazistët gjermanë ishin të furishme ku në, 12 prill të 1944 në operacionin "Gryka e Ujikut" u bënë luftime të ashpra dhe gjermanët ngelën në turpin e tyre. Nga Kallarati shkuan shumë luftëtarë dhe u bashkuan me brigadën e parë "sulmuese". Në grupin e tyre kishte shumë djem dhe vajza nga ky fshat. Asnjëherë nuk e lëshuan pushkën nga dora Kallaratasit. Ndërsa Shukua u rreshtua në radhët e brigadës VIII "sulmuese" në 20 prill të vitit 1944. Pasi u pëshëndet me nënën e tij Xhikon dhe gruan Xhevon do të largohet për në brigadë. Ndërsa Samiu, djali i tij, ende i pa rritur mirë, i thoshte, më merr edhe mua me vete edhe unë dua të luftoj. Ai do të merrte maliherin që kishte shtirë në ditën e lindjes së tij. Ecnin si sokadhe e si drera, vajzat dhe djemtë e Kallararit të veshur me gjerdanë e fishekë maleve të Kurveleshit në drejtim të Zagorisë. Gjatë rrugës u bashkuan edhe shumë të rinj të tjerë si, Hetem Qurduka, Dule Hoxha, Zenel Koshi, Ismail Çako,



Forca të brigades 8 "sulmuese"

e shumë të tjerë të cilët ju bashkuan brigadës VIII "sulmuese". Në Qershor të vitit 1944 brigada e VIII u përfshi në luftime të ashpra Batalioni i tretë, avancoi luftimet drejt Pogonit. Armiku mësynte me artileri. Në agim të datës tetë Qershor, luftëtarët e brigadës tetë hidhen mbi pozicionet armike. Filluan luftimet trup me trup. Armiku u tërhoq nën panik. Së bashku me pushimin e grykës së armëve, pushoi edhe zemra e Shuko Karabolit, i cili ishte plagosur nga një predhë artilerie. Së bashku me të ranë në fushën e betejës edhe mitralieri Ismail Ramo Çako dhe tre partizanë të tjerë të cilët sot ndrijnë në altarin e lirisë për të mos vdekur kurrë. Shtabi brigadës i dërgon këtë njoftim familjes së Shaqo Karabolit pas rënjes së tij në fushën e betejës aty, në Sopik të Zagorisë. Më datën 8 Qershor 1944 në zonën e Sopikut, Gjirokastër u zhvilluan luftime të ashpra midis partizanëve të brigadës tetë "sulmuese" dhe forcave naziste e tradhëtare. Aty ra heroikisht në luftën për liri partizani Shuko Ramo Karaboli. Betohe mi se do t'ia marrim hakun atij dhe gjithë të rënëve për liri e për Atdhe! Me marrjen e njoftimit nëpërmjet të vëllait i cili ishte pjestar i kësaj brigade, nënë Xhikua Pasi mori lajmin për humbjen e të birit, ajo do ta vajtonte me ligjërimë: "Më erdhi letra me vëllanë/ Mbahu moj Xhiko më thane/ Se Shukua të është vrrarë/ Rrotull më erdhi shtëpia/ U hoq kulmi nga çatia/ Gjaku Shukos, Shqipëria!"



Qendra e fshatit Kallarati

## LETRAT

# “Kosova është Shqipëri” dhe “Libra dhe autorë”, dy botime të që pasurojnë fondin e letërsisë dokumentare

## Shpendi Topollaj vjen me dy libra të rinj!

Nga Fatmir Minguli

Në fund të janarit 2024 dolën nga shtypi dy libra të shkrimtarit, poetit, publicistit dhe kritikut letrar, Shpendi Hulësi Topollaj, “Kosova është Shqipëri” dhe “Libra dhe autorë” botime të studios 2M në Durrës.

Libri i pare “Kosova është Shqipëri” është një përmbledhje artikujsh studimorë, me karakter tejet social për problemet që lidhen me Kosovën. Libri i kushtohet Adem Jasharit.

Në këtë libër, autori kryesisht u drejtohet politikanëve shqiptarë duke i thirrur për të bërë bashkimin kombëtar, për përuljet e turpshme ndaj të huajve, për pritjet e kota politike pozitive nga Vuçiq, një pikëpyetje për vetë OKB -në, për mbrojtjen e kulturës dhe gjuhës shqipe si dhe shumë aspekte të përditësuar në ngjarje dhe probleme akute të Shqipërisë lidhur me Kosovën dhe Çamërinë. Në këtë vëllim ndryshe nga shumë libra të autorëve të ndryshëm ka goditje të drejtë përdrejtë të karakterit publicistik, mund të themi se është një vazhdim struktural i librit të



botuar vetëm pak kohë më parë “Shqiptarët dhe ndërkombëtarët”.

Ndërsa libri i dytë që po analizoj shkurtimisht në këtë artikull, “Libra dhe autorë” është një pasqyrë e veprimtarive intelektuale të shkrimtarëve, artistëve dhe studjuesve.

Mes analizave të mirfillta që Shpendi bën për autorë shkrimtarë jo vetëm durrsakë, lexuesi do të marrë esencën e librave që analizohen. Shkrimtarët që studjohen në këtë libër, janë Bashkim Hoxha, Robert Martiko, Bajram Gashi, Teuta Dhima, Ilir Paja, Grisilda Doçi, Eralda Baze, Bajram Sulejmani, Xhevdet Çela.

Ndërsa studjuesit Mark Zadeja, Irakli Koçolari, Selman Sheme, Bashkim Kadiu, Valentino Mustaka, Alfred Uçi, Enver Isufi gjejnë përsiatjet më pikante për veprat e tyre në librin e Shpendit. Piktorët Pashk Përvathi dhe Arben Kristani së bashku me kompozitorin Nikolla Zoraqi vinë tejet të ndriçuar për veprat e fundit.

Shpendi Topollaj bën një homazh të përshpirtshëm për të ndjerin, intelektualin durrsak Piro Dollani. Nëse librin e pare ia kushton Adem Jasharit, heroit të madh të Kosovës librin e dytë, “Libra dhe autorë” ia kushton Mark Zadesë, intelektualit, shkrimtarit, studjuesit të filozofisë, piktorit, koleksionistit dhe kritikut të artit, nga Shkodra.

## 8 MARS

Nga libri “Nënë Xharies” i Liço Liçi: “Dashuria për nënën nuk matet me asnjë vlerë monetare, ajo kërkon vetëm shpërblim shpirtëror”...

## Përmendore me fjalë shpirti

Nga Liljana MUÇA

Jeta është jo vetëm ekzistenca frymore e njeriut, por mbi të gjitha ekzistenca e të qenurit njeri me shpirt të madh. Pikerisht ky është mesazhi kryesor që percjell autori i këtij libri Liço Liçi. Për nga lloji letrar është poemë, e cila përshkohet nga fryma e një raporti të ndërsjelltë, nënë- bir dhe bir - nënë. Bazuar në këtë raport, rrjedhin si ujrat e kristalta të Gjergjevicës kujtimet e autorit për nënën e tij.

Liço Liçi, jo vetëm si mjeshtër i përpunimit të gurit, i cili e bën gurin të flasë artistikisht, aftësi të cilit ia ka dhënë treva e Oparit prej nga vjen vetë autori, por edhe i fjalës artistike, të cilën e percjell me një emocion të forte, të dashurisë, mallit dhe respektit për nënë Xharies.

Në hyrje të poemës të tërheq vëmendjen një gjetje e bukur artistike, ku me anë të pyetjes retorike, realizohet një komunikim ndërplanetar, për të shprehur përmasat e një malli të madh të birit për nënën në mungesë...

“E pyeta Hënë / / që ndriçon gjithë dynjanë / A ma ke parë gjë nënën ? / Nje vit kam pa e parë...”

E në vazhdim të mallit që nuk tretet, varg pas vargu e strofë pas strofë formëzohet portreti i Nënës, në të cilin lexuesi përfytyron gruan unike; si një bashkëshorte dinjitoze që qëndron e fortë në themelin e familjes, në mirëmbajtjen, në mirëritjen dhe edukimin e fëmijëve. Ishin derë e hapur për bujari dhe mikëpritje të miqve, vlera keto të trashëguara që nga vajzëria në familjen e saj e më

pas të përforuara në familjen e re.

Autori ka pasqyruar sipas kujtimeve të nënë Xharies kur ajo tregon me krenari përfshirjen e familjes së Ali Liçit, vjerrit të saj, në Lëvizjen e Madhe të Luftës Çlirimtare kundër okupatorëve nazi - fashistë. Në shtëpinë e tyre hynin e dilnin ilegalë dhe gjithë natën gatuheshin vakte buke për luftëtarët e lirisë.

Liço Liçi, si i vetmi djalë në familje, për nënë Xharies ishte e vetmja dritë syri që i kishte mbetur, pasi një djalë tjetër që nuk ishte më në jetë, i kishte dhënë asaj një goditje të përballueshme që mund t'i ndodhë një nëne...

Ajo e rriti dhe e edukoi të birin për të përballuar me guxim vështirësitë e jetës, ashtu siç ajo diti të bëjë më të mirën për atë.

Si shpesh herë duke e pirë kafën me nënën e tij pranë oxhakut, kujtimet marrin arratinë ndër vite e dekada; me halle e brenga aq të mëdha, sa nuk do të kishte fuqi t'i mbante në kurriz as mali i Ostrovicës.

Por jeta me dimensionet e saj u rezervoi edhe gëzime. Njëpër dasma apo lindje nipërishe e mbesash, nënë Xharies provonte ndjesitë e gëzimit të paparë, duke hequr vallet apo duke ja marrë këngës.

E tillë ishte ajo, me një shpirt luftarak, babaxhane që dinte t'a mundte dhimbjen. Pikerisht të tilla momente mbresëlënëse i kanë ndezur të birit frymëzimin për të vargëzuar me fjalë shpirti. Pena që rrëshket mbi letër dhe mendja që riprodhon kujtimet, shpalosin përfytyrime të pashlyeshme tek autori.



“Botës bukurinë / Ia jep vetëm nëna / Qiellit dhe Tokës / Dielli dhe Hëna”. Janë këto, vargje me një qasje të arrirë stilistike. Përmes një paralelizmi figurativ arrihet në një përgjithësim universal për nënën, pa të cilën bota nuk do kishte jetë dhe ngjyra.

“Nënë ti kur u largove / s'more me vete gjë tjetër / Prandaj këto kujtime / për ty i hedh në letër...”

Nënteksti i këtyre vargjeve sikur të thotë se dashuria për nënën nuk matet me asnjë vlerë monetare, ajo kërkon vetëm shpërblim shpirtëror, ku secili fëmijë e ka për detyrë t'ia japë pa kursim, t'ia japë ashtu siç e

ka marrë prej saj, pa kushte.




“Syri i i Zotit / Dhe zemra e Nënës / Nuk të braktisin kurrë...”

Janë këto vargje dedikimi më i mirë i autorit në kujtim të nënë Xharies, për t'i thënë kujtdo fëmijë: duajini prinderit siç doni sytë e ballit tuaj. U jepni atyre shumë ngrohtësi, përkujdesje e dashuri, siç ata ua kanë dhënë juve.

Me penë e zemër në dorë, Liço Liçi shkroi me krenari për nënën e tij, për ta patur si shembullin më të mirë në sfidat e jetës dhe për t'i përballuar ato siç ajo i përballoi. E meritonte këtë përmendore dhe Liço e bëri me fjalë shpirti.

HOMAZH

# U shua kolonjari dhe atdhetari, Myslim Islami



Nga e majta, Shefqet Sejmini, Halil Rama, Myslim Islami dhe Nuredin Musaj

Nuk kam patur fat dhe moshë të kisha miqësi të hershme me Myslim Islamin. Kur e kam takuar shumë vonë rastësisht, u trondita jashtëzakonisht emocionalisht...

E para, sepse Roshanji i tij me Rehovën time ndodhen njëzetë minuta larg dhe kanë bashkëjetuar në një kooperativë bujqësore, duke dhënë e marrë shumë me njëri tjetrin në përditshmërinë e tyre.

E dyta, nuk e di nëse e kishte frymëzim apo kujtesë, por më tregoi se më mbante mend që kur isha në shkollën fillore, të ulur në bangën e parë dhe me mësues Izet Fejzullain. Ai vinte për inspektim sepse atëherë ka qenë në seksionit e Arsimit të rrethit.

E treta, më rrëfente ndodhi mbresëlënëse për bashkëfshatarët e mij duke më bërë krenar dhe të lumtur për bujarinë, mikëpritjen dhe fisnikërinë e tyre.

Pra, unë e kam njohur atëherë kur ai kishte filluar të përdorte bastun... I shkonte shumë! Më përngjasonte me ata burrat e qëmotit, gjithë mënçuri, autoritet dhe lezet. Sepse, i tillë ishte Myslim Islami! Një kolonjar dhe atdhetar i vërtetë! Kishe qejf ta dëgjoje kur fliste, sepse nga shpirti i buronte dituri, dhembshuri dhe krenari për vendlindjen dhe të parët e tij. Kishte të drejtë! Më mirë se ai nuk ka

mundur kush, të zbulojë rrënjët e fisit. Tregon se stërgjyshi, Delijaço që në turqisht do të thotë trim, ka qenë krah i Ali Pashë Tepelenës. Bilali, gjyshi, kishte miqësi me Themistokli Gërmenjin dhe të dy bashkë kanë marrë pjesë në Kongresin e Manastirit. Estrefi, babai që kishte patur mësues Petro Nini Luarasin, në një fotografi të 4 shtatorit 1920, shfaqet me dinjitet në Vlorë, ditën e çlirimit...

Myslim Islami edhe njëqind mundësi të tjera sikur të kishte patur në këtë jetë, me siguri do të shfaqte frymëzimin dhe motivimin e historianit. Ashtu si dhe në të vërtetë, arriti që të shpaloste me dinjitet dhe personalitet historinë e Kolonjës dhe të Shqipërisë. Shfletoni librat e tij dhe do të përjetoni sa dhembshuri dhe dashuri ka ndërjerë ai për gjithçka shqiptare. Lexoni tituj në ballinat e tyre! Vetëm histori dhe atdhedashuri!

Jo vetëm në libra por edhe nëpër tavolina me miq dhe shokë, Myslim Islami, nuk të linte radhë për të folur sepse kishte çfarë të fliste me aq pasion dhe mënçuri. Para atij burri, më i fituar dhe i lumturuar do të ishte që të mos harxhoje asnjë minutë kohë për të folur, por veçse të dëgjoje dhe të mësoje. Ishte mjeshtër i fjalës, përzgjidhte çfarë të tregonte dhe më shumë

se ligjëronte, ai... kumbonte! Ai jetoi në sistemin komunist dhe punoi në aparatën më të lartë partiak të kohës. Edhe unë e kam "ngacmuar" për atë periudhë, por ndjehem i penduar në aludimet e mija, tani që jam duke lexuar ditarin e vet. Sepse, realisht nuk është se ka qenë dhe shumë i ledhatuar. Madje, disa herë i sulmuar dhe i dyshuar. I kritikuar dhe i ndëshkuar. Sikur të mos i mjaftonte preferenca dhe dëshira që të shkruante monografi për heronjtë e vërtetë dhe jo ata që abuzuan me gjakun dhe veprën e tyre, disa herë në kolektivin e punës parimisht dhe guximshëm kritikoi edhe të "papakshmit"...

Manipulime dhe padrejtësi që me shumë duf dhe vërtetësi i pasqyroi me shkrimet e tij në vitet e demokracisë. Më shumë se në interes të vetvetes, për vërtetësinë dhe Shqipërinë. Lexoni librat e tij dhe do ta besoni!

Thashë që nuk kam mundur ta njoh nga afër Profesor Myslimin, por çdo bashkëatdhetar që do të ketë shansin të lexojë librat e tij, pas çdo faqeje do të ndjehet i lumtur dhe krenar që është shqiptar. Akoma më mirënjohës, nëse do të jetë... kolonjar!

AGRON SEJAMINI

